

RAPORTI VJETOR





Banka e vendit tënd

RAPORTI
VJETOR
2018

www.bpbbank.com

PËRMBAJTJA

LETRA E KRYETARIT TË BORDIT	3
LETRA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	5
STRUKTURA ORGANIZATIVE	8
REZULTATET FINANCIARE SIPAS IFRS-së	9
KLIENTËT BIZNESE DHE PERSONAT INDIVIDUALË	11
BURIMET NJERËZORE	15
DZHP DHE TI	17
PAJTUESHMËRIA DHE AML	19
MENAXHIMI I RREZIKUT	21
PËRGJEGJËSIA SOCIALE	23
PASQYRAT FINANCIARE	25



Albert Matoshi

LETRA E KRYETARIT TË BORDIT

I nderuar lexues,

Kam nderin të raportoj një performancë tjetër të shkëlqyer në vitin 2018 për Bankën për Biznes të cilës i ka paraprirë një vit financiar pozitiv dhe një mjedis tregu relativisht i qëndrueshëm në vend. Totali i aseteve në sektorin bankar arriti vlerën prej 4 miliardë euro, me një rritje të dukshme prej 11% në kreditë e klientëve dhe 8,7% në depozita, ndërsa niveli i kredive me probleme (2,7%) mbeti më i miri në rajon.

Banka për Biznes ka arritur rritje të rëndësishme në të gjitha segmentet kryesore. Njëjtë si në vitin e kaluar, Banka realizoi një fitim neto stabil në vlerë 5,5 milionë euro, që i atribuohet rritjes së mëtejme të portofolit të kredisë në shumë prej 157 milionë euro, krahasuar me 131 milionë euro nga e njëjta periudhë e një viti më parë, dhe rritjes së të hyrave nga interesi në shumë prej 11,6 milionë euro, krahasuar me 9,9 milionë euro në vitin 2017. Në anën tjetër, niveli i depozitave, si burimi ynë kryesor i huadhënies për klientët tanë, arriti në 221 milionë euro, nga 177 euro sa ishte një vit më parë. Të gjitha këto rezultuan në rritjen e kapitalit të përgjithshëm të Bankës në 25 milionë euro, nga 20 milionë euro sa ishte në vitin paraprak.

Edhe këtë vit, përmirësimet në shërbimin ndaj klientëve dhe produktet e Bankës vazhduan të jenë fokusi kryesor i strategjisë sonë. Cilësia e portofolit të kredisë është përmirësuar nga 2,97% sa ishte në vitin 2017 në 2,87% në vitin 2018, duke qenë në përputhje me trendin e përmirësimit të kredisë në nivelin e industrisë bankare. Ky përmirësim në cilësinë e aseteve u bazua në uljen e përcaktuar të kredive me probleme gjatë viteve të fundit. Si rezultat, këto arritje u njohën nga revista e njohur financiare "The Banker", e cila i dha BPB-së çmimin prestigjioz "The Best Bank of 2018" (Banka më e mirë në vitin 2018).

Rezultatet e arritura nga Banka këtë vit gjithashtu konfirmuan se vendimet strategjike të marra gjatë viteve të fundit kanë luajtur një rol kyç duke ndihmuar Bankën që të dalë me sukses nga një periudhë sfiduese e transformimit me forcë të shtuar. Për këtë, unë jam i bindur se Banka do të ketë një performancë tjetër të qëndrueshme në vitin 2019, pasi që biznesi ynë vazhdon të gjenerojë të ardhura të besueshme me efikasitet në sektorë udhëheqës. Kjo mbështetet nga forca solide e kapitalit dhe administrimit të kujdesshëm të rrezikut që është ndërtuar gjatë viteve të fundit.

Për fund, në emër të Bordit të Drejtorëve, do të doja t'i falënderoj klientët tanë besnikë për besimin dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme dhe të shpreh mirënjohjen time për të gjithë punonjësit e Bankës për ekspertizën, përkushtimin dhe arritjet e tyre të rëndësishme në vitin 2018. Kam besimin se Banka ka nivelin dhe fuqinë për të siguruar performancë të qëndrueshme në vitet në vijim.

Në emër të Bordit të Drejtorëve,

Albert Matoshi

Kryetar i Bordit të Drejtorëve





Arton Celina

LETRA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Të nderuar lexues,

Viti 2018 ka qenë një vit i mirë si për ekonominë tonë ashtu edhe për sektorin financiar në Kosovë. Padyshim që ekonomia e Kosovës, si ekonomi e integruar dhe e varur si nga regjioni ashtu edhe vendet tjera prej nga vjen diaspora jonë si furnizuese e remitancave, ndikohet nga zhvillimet politiko-ekonomike në mbarë globin. Në këtë aspekt, Kosova edhe në vitin 2018 ka vazhduar me rritjen ekonomike me rreth 4%, si vazhdimësi e trendeve pozitive të rritjes ekonomike, dhe ky është një indikacion stabil për trendet në të ardhmen.

Sistemi bankar i Kosovës në përgjithësi ka vazhduar të qëndrojë stabil dhe të jetë ndër shtyllat e pakontestueshme të ekonomisë kosovare. Nivelet e ulëta të kredive joperformuese, rreth 3%, dhe rritja kreditore e sektorit bankar me mbi 10% janë ndër karakteristikat kryesore që flasin shumë për qëndrueshmërinë e sistemit dhe zotimin e bankave për një bankim të konsoliduar dhe mirë të organizuar në këtë mjedis ekonomik.

BPB edhe në vitin 2018 ka vazhduar me avancimin e saj në drejtimet strategjike të përcaktuara në vitin 2016, e që janë zgjerimi i bazës së klientelës në segmentet kryesore - NVM dhe Klientët Pagëmarrës, ngritja e infrastrukturës teknologjike për të përkrahur rritjen e vazhdueshme të biznesit si dhe përmirësimi i proceseve të brendshme në ngritjen e shërbimeve ndaj klientelës. Në të tri drejtimet strategjike janë ndërmarrë hapa konkretë dhe rezultatet e arritura tregojnë se Banka është në rrugë të mirë drejt avancimit të saj në treg dhe të qenët faktor i rëndësishëm me pjesëmarrje aktive në sektorin bankar.

Rezultatet financiare kanë vazhduar të jenë jashtëzakonisht të suksesshme si në aspektin e profitit dhe rrjedhimisht kthimit në ekuitet, ashtu edhe në rritjen kualitative të portfolios kreditore me një diversifikim të theksuar të ekspozimeve të mëdha dhe me një normë të pranueshme të kredive joperformuese. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2018, BPB u shpall si banka më e mirë në Kosovë për vitin 2018 nga revista prestigjioze "The Banker", e botuar nga "Financial Times".

Banka ka vazhduar të punojë drejt ngritjes së kualitetit të shërbimeve dhe produkteve të reja të cilat shtojnë vlerë në biznesin ditor të klientëve tanë, shërbime këto të cilat dëshmojnë që Banka jeton

me klientët e saj dhe në vazhdimësi është e interesuar që zgjidhjen e problemeve të klientëve ta ketë prioritet të vazhdueshëm.

Të gjitha këto nuk kanë mundur të arrihen pa një relacion të veçantë me klientët tanë dhe kjo për ne është me rëndësi të jashtëzakonshme dhe për këtë investojmë çdo ditë të punës sonë. Po ashtu, shfrytëzoj rastin që t'i falënderoj të gjithë personelin e BPB-së për këto të arritura gjatë vitit 2018 dhe jam i sigurt që viti 2019 do të jetë edhe më i suksesshëm pasi për këtë kemi filluar te punojme që nga tani.

Sinqerisht,




The Banker




Banka më e mirë e vitit 2018

KOSOVË

STRUKTURA ORGANIZATIVE





REZULTATET FINANCIARE SIPAS IFRS-së

Gjatë vitit 2018, BPB realizoi të hyra neto nga interesi në shumë prej 11,6 milionë euro. Të hyrat neto nga interesi përfaqësojnë rreth 78,8% nga gjithsej të hyrat operative të Bankës, dhe krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej afër 1,7 milionë euro, ose 17.4%.

Shpenzimet e interesit për vitin 2018 ishin rreth 1,8 milionë euro (2017: 1,5 milionë euro). Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së volumit të depozitave të klientëve për 43,8 milionë euro, apo për 24,6%, krahasuar me vitin paraprak, përderisa norma mesatare e interesit në depozita ishte mjaft stabile përgjatë gjithë vitit 2018.

Margjina neto e interesit ishte 7,0% nga 7,6% sa ishte vitin e kaluar, e kjo si rezultat i rënies së normës së interesit në kredi.

Kategoria e dytë e të hyrave për nga madhësia janë të hyrat neto nga tarifat dhe komisionet të cilat arritën nivelin prej 1,6 milionë euro. Edhe pse të hyrat bruto nga tarifat dhe komisionet u rritën për 2,1%, ishin shpenzimet e tarifave dhe komisioneve që kishin një rritje më të lartë për afër 16,2%, dhe të cilat shkaktuan një zvogëlim në rritjen neto të të hyrave nga tarifat dhe komisionet.

Si rezultat i implementimit të standardit IFRS 9, Banka ka njohur një rritje në rezervën e ndarë për kreditë nga afër 4 milionë euro sa ishte në vitin 2017 në 5,2 milionë euro në fund të vitit 2018. Ndikimi nga implementimi i këtij standardi u njoh në bilancin e hapjes të vitit 2018.

Shpenzimet operative të Bankës gjatë vitit 2018 u rritën për 8,1% krahasuar me vitin 2017. Raporti i kostove operative mbi të hyrat operative u karakterizua me një rritje të lehtë, nga 53,4% sa ishte në vitin 2017, në 56.5% në vitin 2018.

Gjatë vitit 2018 u arrit fitimi neto prej 6,6 milionë euro, duke rritur kështu ndjeshëm ekuitetin e aksionarëve nga 21,1 milionë euro në vitin 2017 në 25.6 milionë euro në fund të vitit 2018. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar ishte 28,3% këtë vit dhe 29,8% në vitin e kaluar.

Gjatë vitit 2018, BPB shënoi përmirësim sa i përket treguesve të adekuatshmërisë së kapitalit, ku gjithsej kapitali mbi mjetet e peshuara me rrezik ishte 15,7%, nga 15,4% sa ishte në vitin 2017. Gjatë këtij viti, Banka mori edhe një borxh të ndërvarur në shumë prej 0,5 milionë euro nga BlueOrchard. Ky borxh do të përdoret për financimin e kapitalit të klasës së dytë.

Investimi në letra me vlerë të emetuara nga ana e Qeverisë së Re-

publikës së Kosovës gjatë vitit 2018 u rrit për 13,0 milionë euro, duke rezultuar në 30,1 milionë euro në fund të vitit 2018, nga 17.2 milion euro sa ishte në fund të vitit 2017.

Edhe gjatë vitit 2018, BPB vazhdoi të rrisë stabilitetin e fondeve duke u fokusuar në depozita më stabile dhe më afatgjata, si dhe në diversifikimin e strukturës së tyre duke kaluar prej depozitave me vlera më të mëdha nga institucionet e ndryshme në depozita me vlera më të vogla nga personat fizikë dhe NMV-të të cilat konsiderohen si më të qëndrueshme dhe më stabile.

Edhe gjatë vitit 2018, Banka vazhdoi bashkëpunimin me institucionet financiare ndërkombëtare sikurse Fondi Evropian për Evropën Juglindore (FEEJ) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Gjatë vitit 2018, BPB nënshkroi edhe një marrëveshje për kredi me BERZH-in për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe atyre të mesme në shumë prej 5 milionë euro. Gjatë vitit 2018 u arkëtua shuma prej 2,5 milionë euro, ndërsa pjesa tjetër prej 2,5 milionë euro do të arkëtohet në vitin 2019.



KLIENTËT BIZNESE DHE
PERSONAT INDIVIDUALË

Gjatë vitit 2018, BPB ka vazhduar ofrimin e shërbimeve kualitative bankare të ofruara ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM-VE) si dhe personave individualë (PI) me qëllim të përkrahjes dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të tyre. Përveç financimit dhe depozitave, Banka ka qenë e fokusuar në ofrimin e shërbimeve elektronike bankare, gjegjësisht kanaleve tjera alternative të distribuimit.

Në vitin 2018, portfolio e depozitave është rritur për 44 milionë euro ose për 25%, ku llogaria rrjedhëse ka shënuar rritje prej 27.7 milionë, llogaria e depozitave me afat është rritur për 16.1 milionë, gjersa llogaria e kursimeve është mirëmbajtur. Rritja e depozitave në llogarinë rrjedhëse na konfirmon se klientët kanë rritur qarkullimin me bankën tonë. Në anën tjetër, portfolio kreditore bruto është rritur për 26,5 milionë ose 19.4%, ku rritja prej 14.6 milionë vjen nga bizneset gjersa rritja 11,9 milionë vjen nga personat individualë. Nga 14.6 milionë euro, 88% e rritjes së portfolios kreditore të biznesit vjen nga bizneset mikro dhe agrobizneset. Banka shpërndau ekspozime kreditore në shumë prej 113 milionë euro. Nga 8.282 ekspozime kreditore të shpërndara, 45% prej tyre ishin tek klientët e rinj. Krahaz zhvillimeve, Banka ka pasur edhe përmirësim të kualitetit të portfolios, që ka rezultuar në uljen e normës së kredive joperformuese. Ofrimi i shërbimeve elektronike dhe ngritja e kualitetit të tyre ka qenë prioritet i Bankës gjatë vitit 2018, ku Banka ka lansuar platformat më të reja M-Banking dhe E-Banking, shërbime të cilat kanë ndikuar direkt në kursimin e kohës dhe të shpenzimeve të klientëve. Numri i klientëve që përdorin platformën tonë të E-Banking dhe M-Banking ka shënuar rritje prej 22%.

Me qëllim të plotësimit të kërkesave të klientëve, gjatë vitit 2018 kemi vazhduar me dizajnimin e ofertave specifike për sektorë specifikë, gjë që ka ndikuar direkt në ngritjen e efikasitetit të punës së bizneseve dhe personave individualë. Ngritja e efikasitetit dhe plotësimi i nevojave të klientëve do të mbetet fokus i Bankës.

Banka ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e kualitetit të shërbimit ndaj klientëve biznese duke zgjeruar hapësira të veçanta për t'i shërbyer këta klientë. Këndi i Biznesit është shfrytëzuar për edukimin e klientëve mbi përdorimin dhe shfrytëzimin e shërbimeve elektronike. Kjo hapësirë është vlerësuar shumë mirë nga klientët ekzistues dhe ka shërbyer edhe si urë lidhëse për klientët e rinj të BPB-së.

Në vazhden e përkrahjes së klientëve tanë, BPB-ja ka qenë banka e parë e cila ka nënshkruar marrëveshjen me BERZH-in (Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) për rritjen e konkurrencës së

ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vlerë prej 5 milionë euro. Përveç qasjes në financim, NVM-të gjithashtu do të përfitojnë grante të financuara nga IPA (Instrumenti për Ndihmën para Anëtarësimit) e BE-së, të menaxhuar nga EUO/EUSR Kosovo nën Programin e BERZH-it për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë për NVM-të në Kosovë. Ky program do t'ua mundësojë NVM-ve në Kosovë të marrin ndihmë për t'u zhvilluar drejt standardeve të BE-së të parapara nga BERZH-i dhe BE-ja sipas parametrevë të Programit për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë për NVM-të në Kosovë. Kredia e BERZH-it si incentive mundëson grantin prej 15% të vlerës së kredisë, gjë që nënkupton se ul koston e investimit në masë të dukshme. Këto fonde do të përdoren për qëllime specifike që ndihmojnë përmirësimin e objekteve afariste të prodhimit dhe për të përmirësuar nivelin e mbrojtjes ndaj ambientit, sigurisë në punë dhe cilësinë e produkteve në përputhje me standardet e BE-së. Një kombinim i financimit afatgjatë, bashkëpunimit teknik dhe nxitjes së investimeve formon një pako të dizajnuar për të ndihmuar në zhvillimin e potencialit të plotë të NVM-ve të vendit.

Përveç programit për klientët biznese, BPB-ja ka investuar fuqishëm në mbështetjen e investimeve familjare njëkohësisht. Fondi "Green for Growth Finance" ka qenë një iniciativë e cila ka ndihmuar si Bankën ashtu edhe klientët në edukimin financiar dhe investimet e mençura, të cilat ndihmojnë në uljen e konsumit të energjisë dhe rritjen e komfortit shtëpiak. Vetëm përmes kësaj linje, Banka ka arritur t'i shpërndajë mbi 1 milion euro kredi për investime shtëpiake.

Për të ngritur kualitetin e personelit, Banka ka investuar në trajnime të ndryshme, si në aspektin e kujdesit ndaj klientit dhe shitjes, ashtu edhe në fushën e rrezikut dhe kreditimit. Po ashtu, për të ngritur kualitetin e shërbimeve të ofruara përmes Qendrës së Thirrjeve, është trajnuar stafi përgjegjës me qëllim që në kohë reale të ofrojnë mbështetje teknike dhe këshilla për përdorimin dhe informata mbi të gjitha shërbimet e Bankës.

Sektori i agrobiznesit është një nga shtyllat e zhvillimit ekonomik dhe ndikon në rritjen e punësimit në vend. Ky sektor kontribuon me mbi 10% në BPV-në e vendit. Edhe gjatë vitit 2018, Banka ka zgjeruar kapacitetet e stafit dhe ka ofruar në mënyrë specifike shërbime dhe produkte bankare bazuar në nevojat e agrobizneseve. Me qëllim të përkrahjes së agrobizneseve, Banka, edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar bashkëpunimin me aktorët kryesorë si MBPZHR, komunat e ndryshme si dhe organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare. Ne kemi arritur marrëveshje bashkëpunimi me kompani prestigjioze në Kosovë që t'u ofrojmë fermerëve mundësi financimi me norma preferenciale të interesit për blerje të makinerisë së re dhe inputeve


bujqësore me qëllim të zgjerimit të biznesit të tyre. Portfolio kreditore agro ka shënuar rritje prej 67% në vitin 2018. Banka do të vazhdojë me ofrimin e shërbimeve dhe produkteve kreditore bazuar në kërkesat e agrobizneseve me qëllim të përkrahjes së tyre dhe ngritjes së kapaciteteve.

Përveç tjerash, Banka është fokusuar edhe në rritjen e mundësive për qasje në financim për bizneset e vogla të mesme dhe agrobiznese. Në këtë drejtim, ne kemi rritur bashkëpunimin me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, në mënyrë që klientëve të cilët nuk kanë mbulueshmëri të mjaftueshme të kolateralit t'u ofrojmë qasje në financa. Kemi punuar në identifikimin e klientëve të cilët plotësojnë kushtet për investime dhe kemi kredituar projekte të konsiderueshme të cilat kanë rezultuar si të suksesshme në pikëpamje të FKGK-së dhe të Bankës si kreditues. Gjatë vitit 2018 kemi rritur limitin me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore për bizneset e vogla dhe të mesme, dhe po ashtu Banka ka nënshkruar fondin garantues "Dritarja Agro" me FKGK-në (Fondi Kosovar për Garanci Kreditore) për përkrahje financiare për agrobiznese.


BPB ka një rrjet të gjerë të degëve dhe staf profesional që ua mundëson klientëve të saj të kenë qasje të shpejtë dhe të lehtë në produktet dhe shërbimet bankare. Gjatë vitit 2018 janë bërë ndryshime dhe investime të rëndësishme në përmirësimin e rrjetit të degëve duke synuar lehtësimin e qasjes së klientëve në shërbime bankare. Zhvendosja dhe hapja e degëve të reja dëshmojnë fuqishëm strategjinë tonë që ka për objekt shërbimin sa më kualitativ ndaj klientëve të Bankës.

Si rezultat i të gjitha investimeve dhe arritjeve, BPB është zgjedhur si 'Banka më e mirë e vitit 2018' nga revista prestigjioze 'The Banker', e publikuar nga 'Financial Times'. Çmimi i fituar na bën të besojmë që strategjia jonë dhe investimet e vazhdueshme po reflektojnë në rritjen e qëndrueshme të Bankës dhe ofrimin e shërbimeve kualitative.

Depozitat



Kreditë Aktive







BURIMET NJERËZORE

Edhe në vitin 2018, Banka për Biznes ka vazhduar me trendin e zhvillimit të saj, ku është vazhduar me investimin në ngritjen e kompetencave të kapitalit njerëzor në mënyrë që, përmes ngritjes së produktivitetit dhe efikasitetit në punë, të realizohet vizioni i Bankës që të jemi bankë e qëndrueshme për aksionarët, institucion kredibil për të punësuarit si dhe liderë në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve financiare për ndërmarrje të vogla dhe të mesme në Kosovë.

Fokusi në rekrutimin e të punësuarve kompetentë në fushën e sistemit bankar ka ndikuar në krijimin e një kulture të re pune si dhe ka bërë të mundur realizimin e planit ambicioz të Bankës.

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit në rekrutimin dhe përgatitjen e të rinjve për tregun bankar, gjatë këtij viti kanë diplomuar studentët e grupit të parë nga programi BPB Juniors. Banka është përkushtuar që përmes këtij programi t'u japë mundësi pjesëmarrësve që të trajnohen nga stafi profesional me përvojë shumëvjeçare në sistemin bankar dhe që të zhvillohen për t'u bërë bankierë të suksesshëm në të ardhmen. Të punësuar nga ky grup numërojmë 8 studentë, ndërsa vlen të theksohet që në pjesën e dytë të vitit 2018 është kryer procesi i rekrutimit për studentët që do jenë pjesë e BPB Juniors 2.

Pjesë shumë e rëndësishme e strategjisë së burimeve njerëzore krahas ngritjes së kompetencave të të punësuarve dhe motivimit të tyre ka qenë edhe orientimi në karrierë. Orientimi në karrierë, si qëllim kryesor ka motivimin dhe mbajtjen e të punësuarve me performancë të shkëlqyer në punë si dhe me potencial për t'u promovuar në pozita udhëheqëse në të ardhmen. Ky koncept është krijuar me qëllim që të punësuarit t'i kenë të qarta kriteret e avancimit të njohurive dhe kompetencave të tyre si dhe mundësitë e promovimit dhe avancimit në karrierë brenda Bankës.

Duke pasur parasysh rëndësinë e investimeve në trajnime dhe zhvillim të të punësuarve, edhe këtë vit është organizuar trajnimi profesional për avancimin e aftësive të udhëheqjes, trajnim ky i cili ka ndihmuar udhëheqësit që të përshtaten me kulturën e re të punës në Bankë dhe që të reflektojnë mbi ndryshimet e nevojshme brenda ekipit të tyre me qëllim të realizimit të objektivave të departamentit dhe të Bankës në përgjithësi. Trajnimi i njëjtë është organizuar edhe për të punësuarit e identifikuar si me potencial për avancim në pozita udhëheqëse, tek të cilët ky trajnim ka ndikuar në motivim dhe zhvillim të aftësive të tyre udhëheqëse. Gjithashtu, është bërë identifikimi i nevojave dhe trajnimi i të punësuarve në shitje për qasjen dhe kujdesin ndaj klientit, si dhe trajnime tjera që kanë ndikuar pozitivisht në zhvillim profesional të punonjësve të Bankës.

Ne si bankë i japim shumë rëndësi edhe trajnimeve që organizohen qoftë nga Shoqata e Bankave të Kosovës apo ndonjë institucion tjetër, ku përmes këtyre trajnimeve, punonjësit që përzgjidhen të marrin pjesë përfitojnë njohuri dhe përvojë shtesë, të cilën me pastaj e ndajnë edhe me kolegët e tyre.



DZHP DHE TI

Rrugëtimi i transformimit elektronik në Bankë ka filluar vite më parë dhe vazhdon të fuqizohet çdo ditë e më tepër, krahas trendeve globale të avancimit të teknologjisë dhe kërkesave të vazhdueshme të klientëve. Në përputhje me strategjinë e Bankës dhe me synimin për të ofruar kanale shtesë për përmbushje të nevojave të klientëve, Departamenti për Zhvillim të Produkteve dhe Teknologjia Informative janë përpjekur të ofrojnë alternativa të qëndrueshme dhe afatgjate që klientëve u sjellin mundësi shtesë për t'i plotësuar nevojat e tyre me komoditet, në mënyrë elektronike 24/7, pavarësisht nga orari i punës.


Nëse i referohemi vitit paraprak, Banka ka lansuar me sukses platformat e reja dhe shumë të sofistikuara të bankimit elektronik, duke dhënë një shembull të shkëlqyeshëm të rimodelimit të biznesit me klientë në hap me kohën. Zgjerimi i vazhdueshëm i gamës së shërbimeve dhe ngritja e kualitetit dhe sigurisë së këtyre platformave kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e nivelit të përdorimit duke pavarë-

suar klientët në menaxhimin e transaksioneve financiare të tyre dhe shfrytëzimin racional të kohës.

Për të promovuar më tej këtë qasje inovative, Departamenti për Zhvillim të Produkteve është angazhuar fuqishëm në avancimin e performancës së bankomateve duke investuar në flotën e teknologjisë më të re, duke shtuar funksionalitetin e deponimit të mjeteve në bankomat si dhe duke avancuar shërbimet me kartela në përgjithësi.

Rritja e përdorimit të kanaleve elektronike dhe identifikimi me kohe i nevojave të klientëve drejton Departamentin për Zhvillim të Produkteve dhe Teknologjinë Informative që të ndjekin dhe avancojnë tutje konceptin elektronik të Bankës. Gjithsesi, pavarësisht kanaleve të shumfışhta elektronike bankare, rritja e efikasitetit dhe automatizimi i proceseve të brendshme do të mbesin në fokus të këtyre departamenteve, duke u krijuar hapësire zyrtarëve në degë për thellim të mëtutjeshëm të relacioneve me klientë.





PAJTUESHMËRIA DHE AML

Banka është e përkushtuar në sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe bene përpjekje të vazhdueshme për aplikimin e praktikave më të mira vendore dhe ndërkombëtare të pajtueshmërisë. Aktivitetet e saj të biznesit zhvillohen në mënyrë etike, duke vendosur në prioritet klientin, krijimin e mardhenjës së biznesit nën aplikimin e pakushtëzuar të kornizës rregullative.

Mbikëqyrja e pajtueshmërisë është e organizuar si funksion i veçantë dhe është e vendosur në nivelin e menaxhmentit të lartë, ky funksion ndihmon Menaxhmentin ekzekutiv në mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së përgjithshme të Bankës për Biznes dhe i mban të informuar dhe përditësuar mbi zhvillimet dhe / ose praktikën më të mira në pajtueshmërinë dhe shqyrton këto zhvillime dhe / ose praktikën më të mira për aplikueshmërinë në Bankë.

Zyrtari i pajtueshmërisë jep rekomandime Bordit Drejtues se si (më tej) të zhvillojnë dhe përmirësojnë përgjithësisht pajtueshmërinë me kornizën rregullative të BQK-së.


E gjithë korniza e dokumenteve të brendshme të bankës për biznes është krijuar, në frymën e ligjeve dhe rregullave të zbatueshme vendore dhe ndërkombëtare duke vendosur fokusin në kërkesat, për t'iu përgjigjur rreziqeve të ndryshme të pajtueshmërisë ndaj të cilave Banka mund të ekspozohet.

AML (Kundër Pastrimit të Parasë)

Lidhur me parandalimin e pastrimit të parasë, Banka për Biznes aplikon praktikën më të mira bankare me qëllim të mbrojtjes nga shfrytëzimi i shërbimeve dhe produkteve të Bankës për pastrimin e parave apo aktivitetet e financimit të terrorizmit. Banka për Biznes mbështet luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duke zbatuar parimin bazë "Njih Klientin Tuaj", me ç'rast Banka themelon relacione bankare me ata klientë që ka arritur t'i identifikojë dhe verifikojë se me relacionet e krijuara Banka siguron që aktiviteti i klientëve është në pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet e Bankës.

Objekti dhe qëllimi i bankës lidhur me parandalimin e pastrimit të parasë vazhdon të jetë rritja e efikasitetit të monitorimit të proceseve, shërbimeve dhe raportimit tek autoritetet përkatëse, duke zbatuar kështu pavarësinë dhe përgjegjësinë e Departamentit të Pajtueshmërisë në Bankë. Departamenti i Pajtueshmërisë për parandalimin e pastrimit të parasë dhe luftimin e terrorizmit përcjell implementimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në këtë fushë. Banka për Biznes zbaton rekomandimet e FATF-së për vlerësimin e rrezikut duke analizuar rreziqet që dalin nga pastrimi i parasë dhe veprimet që duhet ndërmarrë për parandalimin e përdorimit të Bankës për këto qëllime. Banka po ashtu përdor softuer me anë të të cilit identifikohen transaksionet potencialisht si të dyshuara.





MENAXHIMI I RREZIKUT

Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut ka vazhduar angazhimin në menaxhimin e rreziqeve dhe avancimin e proceseve që lidhen me fushat e rrezikut për të siguruar harmoni të plotë me ligjet dhe kërkesat rregullative të BQK-së. Lidhur me këtë, është bërë rishikimi i dokumenteve ekzistuese dhe janë krijuar dokumente shtesë sipas kërkesave të reja rregullative.

Në vitin 2018, Banka ka implementuar në tërësi projektin e IFRS 9, është ndërtuar modeli dhe metodologjia për kalkulimin e provizioneve, si dhe janë krijuar të gjitha dokumentet përcjellëse për të qenë në harmoni të plotë me këtë standard. Së shpejti do të finalizohet dhe implementohet edhe aplikacioni për kalkulimin e provizioneve në mënyrë automatike.

Po ashtu, është zhvilluar edhe aplikacioni për menaxhimin e procesit të monitorimit të kredive në mënyrë automatike, aplikacion i cili mundëson monitorimin e të gjitha aktiviteteve të proceseve në kredidhënie.

Si rrjedhojë e përmirësimit dhe automatizimit të shumë proceseve, ka vazhduar edhe më tej përmirësimi i kualitetit të kredive, duke përfshirë të gjitha kategoritë e kredive të klasifikuara. Niveli i kredive joperformuese (KJP) është përmirësuar edhe më tej dhe vazhdon të mbetet në nivelin e mesatares së industrisë bankare. Këtu ka ndikuar edhe strategjia dhe modeli i biznesit të Bankës për diversifikimin e mëtejshëm të kredive, ku fokusi i Bankës vazhdon të jetë financimi dhe rritja e kredive individuale dhe për biznese të vogla (MIKRO dhe AGRO), duke mos u zgjeruar në financimet e ekspozimeve të mëdha kreditore. Kjo strategji e Bankës ka bërë që edhe ekspozimet e mëdha kreditore të zvogëlohen edhe më tej, ku tani kredimarrësi më i madh përbën nën 5 % të kapitalit të klasës së parë dhe në këtë mënyrë Banka ka vazhduar me zvogëlimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha.

Për të qenë në linjë me strategjinë rreth diversifikimit të kredive dhe financimin e bizneseve të vogla, Banka ka vazhduar bashkëpunimin dhe rritjen e limiteve me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, duke u mundësuar shumë bizneseve të vogla qasje në fonde me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të bizneseve të tyre. Po ashtu, Banka ka vazhduar bashkëpunimin edhe më tej me kompanitë e jashtme për menaxhimin e kredive në vonesë, sidomos për kreditë humbje dhe jashtëbilancore.

Sa i përket menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, Banka ka vazhduar me rritjen e depozitave të qëndrueshme, duke siguruar fonde të mjaftueshme për të mbështetur rritjen e biznesit, si dhe duke mbajtur nivele të larta të likuiditetit. Përveç rritjes së depozitave nga klientët, Banka ka vazhduar bashkëpunimet edhe me Institucionet Financiare Ndërkombëtare (BERZH, FEEJ, BlueOrchard), duke siguruar fonde shtesë përmes linjave të ndryshme kreditore.

Sa i përket menaxhimit të rrezikut operacional, Banka ka vazhduar me menaxhimin e rrezikut operacional në linjë me rregulloret e BQK-së dhe standardet ndërkombëtare të Bazelit. Janë ndërmarrë hapa dhe masa për përmirësimin e proceseve ekzistuese dhe rritjen e kontrolleve, ku si rrjedhojë edhe humbjet materiale operacionale kanë qenë minimale.

Banka ka filluar të zhvillojë dhe ndërtojë modelet dhe metodologjinë për implementimin ICAAP-it (Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit), si kërkesë e re rregullative. Lidhur me këtë, Banka ka përcaktuar nivelin e alokimit të kapitalit shtesë për rreziqet tjera të cilat nuk janë të përcaktuara me rregullativën aktuale të BQK-së dhe të njëjtin e ka raportuar për të qenë në harmoni me kërkesat rregullative.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Banka e trajton me shume seriozitet rolin e saj drejt përgjegjësisë sociale. Në përputhje me parullën tonë ‘Banka e vendit tuaj’, BPB përpiqet të rrisë cilësinë e jetës në shoqërinë brenda së cilës vepron. Prandaj, çdo vit, Banka kushton një pjesë të kohës dhe parave për të trajtuar tema që janë me interes për shoqërinë. Si shembull, në vitin 2019, ne jemi angazhuar për projekte mjedisore, duke ndihmuar Kosovën të bëhet më miqësore ndaj mjedisit.

Në vitin 2018, BPB u përqendrua në shëndetin e nënave dhe fëmijëve si dhe në arsim. BPB ishte sponsori platin i ngjarjes kyçe në Kosovë që sjell në pah marrëdhënien nënë-fëmijë dhe shëndetin e tyre. Veprimtaria e organizuar nga OJQ-ja ‘Veprimi për nënat dhe fëmijët’ mbledh kompanitë më të mira të Kosovës me të ardhurat nga ngjarja të dedikuara në përmbushjen e mungesave të ndryshme teknologjike në spitale në tërë Kosovën, kryesisht në seksione pediatrike.

Për më tepër, ne kemi bërë edhe donacione ndaj agjencive që merren me fëmijët me nevoja të veçanta. Banka ka investuar edhe në sistemin arsimor të vendit. Shkollat fillore rurale ishin fokusi kryesor, duke marrë parasysh buxhetin e tyre të kufizuar dhe mungesën e pajisjeve bazë për t’i kryer ligjëratat e tyre të përditshme.

Vitin e kaluar, BPB mbështeti 10 shkolla në projekte të ndryshme. Ne kemi siguruar tabela, renovime të objektit, e fusha sportive. Më e rëndësishmja, ne kemi ngritur një numër të laboratorëve shkencorë për t’i ndihmuar fëmijët që të vënë në praktikë njohuritë e tyre. Kemi ndërtuar një laborator të biologjisë dhe kimisë, kemi ngritur një dhomë kompjuterike dhe kemi kaluar kohë me fëmijët duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre në lidhje me praktikatat e sektorit bankar.





BANKA PËR BIZNES SH.A.

PAS QYRAT FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE
ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT
FINANCIAR PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018
ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

Përmbajtja

Raporti i Auditorit të Pavarur Pasqyrat Financiare

	Faqe
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	3
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	4
Shënime për Pasqyrat Financiare	5-81



EY & Young Certified
Auditors Ltd - Kosovo
Rr. Prizreni 1000, 1001
Prizreni, Kosovo
Tel: +383 38 220 155
Fax: +383 38 220 155
ey@ey.com

INDEPENDENT AUDITOR'S REPORT

To the shareholders of Banka për Biznes Sh.a

Report on the audit of the financial statements

Opinion

We have audited the financial statements of Banka për Biznes Sh.a ("the Bank"), which comprise the statement of financial position as at 31 December 2018, and the statement of comprehensive income, statement of changes in equity and statement of cash flows for the year then ended, and notes to the financial statements, including a summary of significant accounting policies.

In our opinion, the accompanying financial statements presents fairly, in all material respects the financial position of the Bank as at 31 December 2018, and its financial performance and its cash flows for the year then ended in accordance with International Financial Reporting Standards ("IFRS").

Basis for opinion

We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing (ISAs). Our responsibilities under those standards are further described in the Auditor's responsibilities for the audit of the financial statements section of our report. We are independent of the Bank in accordance with the International Ethics Standards Board for Accountants' Code of Ethics for Professional Accountants (IESBA Code) together with the ethical requirements that are relevant to our audit of the financial statements in Kosovo, and we have fulfilled our other ethical responsibilities in accordance with these requirements and the IESBA Code. We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our opinion.

Other information included in Banka për Biznes Sh.a 2018 Annual Report

Other information consists of the information included in Bank's 2018 Annual Report other than the financial statements and our auditor's report thereon. Management is responsible for the other information. The Bank's 2018 Annual Report is expected to be made available to us after the date of this auditor's report.

Our opinion on the financial statements does not cover the other information and we will not express any form of assurance conclusion thereon.

In connection with our audit of the financial statements, our responsibility is to read the other information identified above when it becomes available and, in doing so, consider whether the other information is materially inconsistent with the financial statements or our knowledge obtained in the audit or otherwise appears to be materially misstated.

Responsibilities of management and those charged with governance for the financial statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of the financial statements in accordance with IFRS and for such internal control as management determines is necessary to enable the preparation of financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud or error.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave që janë të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare (vijon)

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se më sipër.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomali të materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Menaxhmenti.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Banka për Biznes Sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k
 Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k
 29 prill 2019
 Prishtinë, Kosovë

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

<i>Në mijë Euro</i>	Shënimet	2018	2017
Të ardhurat nga interesi me normën efektive të interesit	7	13,473	11,377
Shpenzimet e interesit	7	(1,847)	(1,470)
Të ardhurat neto nga interesi		11,626	9,907
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	8	2,367	2,319
Shpenzimet për tarifat dhe komisionet	8	(759)	(653)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet		1,608	1,666
Kthimi nga kreditë e shlyera		993	645
Fitimi neto nga këmbimi valutor		10	12
Fitimi neto nga pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	15	7	1,065
Të ardhurat e tjera operative	9	504	790
Gjithsej të ardhura operative		14,748	14,085
Shpenzimet e humbjes kreditore për kreditë dhe paradhëniet për klientët	16	506	(543)
Shpenzimet e humbjes kreditore për pasuritë financiare	12-15	(22)	-
Kthimi neto i provizionit për garancione		12	27
Rënia e vlerës së pasurive të riposeduara	19	(62)	(197)
Provizionet tjera		(101)	(78)
Shpenzimet tjera operative	10	(7,736)	(7,156)
Gjithsej shpenzimet operative		(7,403)	(7,947)
Fitimi para tatimit në fitim		7,345	6,138
Shpenzimet e tatimit në fitim	11	(753)	(631)
Fitimi neto për vitin		6,592	5,507
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
Zërat që janë apo mund të ri-klasifikohen në fitim apo humbje			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		(22)	-
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare të mbajtura për shitje		-	2
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		6,570	5,509

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri në faqen 81, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2018

Në mijë Euro	Shënimet	2018	2017
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	12	18,679	17,833
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	13	39,146	33,998
Kreditë dhe paradhëniet për banka	14	4,788	1,450
Pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	15	30,138	-
Letrat me vlerë të mbajtura për shitje	15	-	17,152
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	16	157,849	132,551
Pasuritë tjera financiare	17	378	143
Pasuritë tjera	18	410	815
Pasuritë e ri-poseduara	19	93	155
Pasuritë e paprekshme	20	402	338
Prona dhe pajisjet	21	2,830	1,725
Gjithsej pasuritë		254,713	206,160
Detyrimet			
Depozitat nga klientët	22	221,593	177,780
Huamarrjet	23	4,285	4,143
Kreditë e varura	23	1,342	840
Detyrimet tjera	24	1,399	1,673
Provizionet tjera	24	482	506
Detyrimi për tatimin e shtyrë	11	59	124
Gjithsej detyrimet		229,160	185,066
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	25	11,247	11,247
Rezerva tjera të kapitalit	25	857	857
Rezerva e rivlerësimit	25	96	96
Rezerva për vlerën e drejtë		(52)	(30)
Fitimi i akumuluar		13,405	8,924
Gjithsej ekuiteti		25,553	21,094
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		254,713	206,160

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga menaxhmenti i Bankës më 26 prill 2019 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Artan Celina
Kryeshef Ekzekutiv

Arni Berisha
Udhëheqës i Departamentit të
Financave

Pasqyra e pozicionit financiar lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri në faqen 81, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

2

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
Për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018

Në mijë Euro	Kapitali aksionar	Rezerva tjera të kapitalit	Rezerva e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura	Rezerva e vlerës së drejtë	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2017	11,247	857	96	3,702	(32)	15,870
Fitimi i vitit	-	-	-	5,507	-	5,507
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	2	2
Gjithsej të ardhurat (humbyt) tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	5,507	2	5,509
Transaksionet me aksionarët e Bankës	-	-	-	(285)	-	(285)
Dividenda e shpërndarë tek aksionarët	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	11,247	857	96	8,924	(30)	21,094
Ndërkimi i adaptimit të IFRS 9 Shënim 6	-	-	-	(1,683)	-	(1,683)
Gjendja e re fillestare sipas IFRS 9 (Shënim 6)	11,247	857	96	7,241	(30)	19,411
Fitimi i vitit	-	-	-	6,592	-	6,592
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	(22)	(22)
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	6,592	(22)	6,570
Transaksionet me aksionarët e Bankës	-	-	-	(428)	-	(428)
Dividenda e shpërndarë tek aksionarët	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	11,247	857	96	13,405	(52)	25,553

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri në faqen 81, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

3

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

<i>Në mijë Euro</i>	Shënimet	2018	2017
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit para tatimit		7,346	6,138
Zërat jo-monetar në pasqyra financiare:			
Zhvlerësimi	21	595	351
Amortizimi	20	217	133
Fitimi nga shitja e pronave, pajisjeve dhe pasurive të riposeduara		(5)	(160)
Fitimi nga kolaterali i riposëdruar		(428)	(601)
Humbjet nga provizionet e kredive	16	(506)	543
Humbjet nga rënia në vlerë e pasurive financiare		21	
Rënia në vlerë për pasuritë e ri poseduara	19	62	197
Provizione tjera		1	123
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë		(7)	(1,065)
Shpenzimet e interesit	7	1,847	1,470
Të ardhurat nga interesi	7	(13,473)	(11,377)
		(4,330)	(4,248)
Ndryshimet në:			
Kredi dhe paradhënie për bankat	14	(3,345)	(850)
Kredi dhe paradhënie për klientët	16	(26,457)	(28,884)
Rezerva e detyrueshme në BQK	13	(2,770)	(2,674)
Pasuritë tjera	18	405	(674)
Pasuritë tjera financiare	17	(235)	94
Pasuritë e ri poseduara	19	-	694
Depozitat nga klientët	22	43,869	37,056
Detyrimet dhe provizionet tjera		(289)	313
		6,825	827
Interesi i arkëtuar		13,179	11,278
Interesi i paguar		(1,834)	(1,475)
Tatimi në fitim i paguar	11	(611)	(565)
		17,559	10,065
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative			
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Shitjet / (Investimet) nga / në pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë përmes të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse		(12,967)	1,886
Blerja e pronave dhe pajisjeve	21	(1,754)	(1,105)
Blerja e pasurive të paprekshme	20	(280)	(245)
Të hyrat nga shitja e pasurive të riposeduara		428	-
Të hyrat nga shitja e pronave dhe pajisjeve		60	2
		(14,514)	538
Paraja neto (e përdorur/ nga aktivitetet investuese			
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financiare			
Pagesa e huamarrjeve	23	(2,343)	(2,600)
Inkasimet nga huamarrjet	23	3,000	1,500
Dividenda e shpërndarë		(428)	(285)
		229	(1,385)
Paraja neto e gjeneruar nga/(e përdorur në) aktivitetet financiare			
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		3,276	9,218
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	12	36,864	27,646
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	12	40,140	36,864

Pasqyra e rrjedhës së parasë lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri në faqen 81, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

4

Banka për Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
1. HYRJE

Banka Private e Biznesit Sh.a ka marrë licencën për aktivitetet bankare me 29 mars 2001 dhe ka filluar operimin me 24 prill 2001.

Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve më 28 shkurt 2005 dhe pas miratimit final nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK") më datë 22 mars 2005, Banka ka ndryshuar emrin nga Banka Private e Biznesit në Banka për Biznes ("Banka"). Në vitin 2006, Banka është regjistruar si shoqëri aksionare ("Sh.a"). Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e konsumatorëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 9 degëve dhe 17 nën degëve të saj të vendosura në Kosovë (2017: 8 degëve dhe 19 nën degëve).

Pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 ishin autorizuar për t'u lëshuar në pajtim me vendimin e drejtorëve më 29 prill 2019.

2. BAZAT E PËRGATITJES
2.1 Pasqyra e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

2.2 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç pasurive financiare të listuara me poshtë, të cilat janë matur me vlerën e drejtë.

— Instrumentet e borxhit të mbajtura sipas modelit të biznesit për maturim dhe shitje.

2.3 Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara

Në këto pasqyra financiare, Banka ka aplikuar efektivisht për herë të parë SNRF 9, SNRF 15 dhe SNRF 7R, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018. Banka nuk ka adaptuar më herët asnjë standard tjetër, interpretim ose ndryshim që është lëshuar por që ende nuk është efektiv.

2.3.1 SNRF 9 Instrumentet financiare

SNRF 9 zëvendëson SNK 39 për periudhat vjetore më ose pas 1 janarit 2018.

Banka nuk ka ri paraqitur informacion krahasues për vitin 2017 për instrumentet financiare në fushëveprimtarinë e SNRF 9. Prandaj, informacioni krahasues për vitin 2017 raportohet sipas SNK 39 dhe nuk është i krahasueshëm me informacionin e paraqitur për vitin 2018. Dallimet që rrjedhin nga adaptimi i SNRF 9 janë njohur drejtpërdrejt në fitimet e akumuluar që nga 1 janari 2018 dhe janë shpalosur në Shënimin 6.

SNRF 9 paraqiti kërkesa të reja për:

- Klasifikimin dhe matjen e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare,
- Rënie në vlerë të pasurive financiare, dhe
- Kontabilitetin e përgjithshëm mbrojtës, i cili megjithatë ka një zbatim të kufizuar në Bankë, nëse ka.

Detajet e këtyre kërkesave të reja si dhe ndikimi i tyre në pasqyrat financiare të Bankës janë përshkruar më poshtë.

Banka ka zbatuar SNRF 9 në përputhje me dispozitat e tranzicionit të vendosura në SNRF 9.

2.3.1.1 Ndryshimet në klasifikim dhe matje

Data e aplikimit fillestar (d.m.th. data në të cilën Banka ka vlerësuar pasuritë dhe detyrimet e saj financiare ekzistuese sipas kushteve të SNRF 9) është 1 janar 2018. Rrjedhimisht, Banka ka zbatuar kërkesat e SNRF 9 tek instrumentet që vazhdojnë të njihen më 1 janar 2018 dhe nuk i ka zbatuar kërkesat për instrumentet që tashmë janë regjistruar më 1 janar 2018. Shumat krahasuese në lidhje me instrumentet që vazhdojnë të njihen më 1 janar 2018 nuk janë ri paraqitur.

5

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.3 Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara (vazhdim)

2.3.1 SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)

2.3.1.1 Ndryshimet në klasifikim dhe matje (vazhdim)

Të gjitha pasuritë financiare të njohura që janë brenda fushëveprimit të SNRF 9 duhet të maten më pas me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë në bazë të modelit të biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e pasurive financiare dhe karakteristikat e rrjedhës së pasurisë kontraktuale të pasurive financiare.

Në mënyrë të veçantë:

- instrumentet e borxhit që mbahen në kuadër të një modeli biznesi, objektivit i të cilëve është grumbullimi i rrjedhës së pasurisë kontraktuale dhe që kanë rrjedhës së pasurisë kontraktuale që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar, maten më pas me koston e amortizuar;
- instrumentet e borxhit që mbahen në kuadër të një modeli biznesi, objektivit i të cilëve është të mbledhë rrjedhat së pasurisë kontraktuale dhe të shesë instrumentet e borxhit dhe që kanë rrjedhës së pasurisë kontraktuale që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar, maten më pas me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDPATGJ);

Më 1 janar 2018, Banka nuk mban investime të tjera borxhi dhe investime kapitale, modeli i biznesit i të cilave kërkon që ato të maten më pas me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH).

Menaxhmenti i Bankës shqyrtoi dhe vlerësoi pasuritë ekzistuese financiare të Bankës më 1 janar 2018 bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistuan në atë datë dhe konstatoi se aplikimi fillestar i SNRF 9 ka pasur ndikimin e mëposhtëm në pasuritë financiare të Bankës në lidhje me klasifikimin dhe matjen:

- investimi i Bankës në instrumentet e borxhit të qeverisë, të klasifikuara si pasuri financiare në dispozicion për shitje sipas SNK 39, janë klasifikuar si pasuri financiare në VDPATGJ sepse ato mbahen në një model biznesi objektivit i të cilave është për të mbledhur rrjedha të pasurisë kontraktuale dhe për të shitur obligacione, dhe ato kanë rrjedha kontraktuale të pasurisë që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit mbi principalin e papaguar. Ndryshimi në vlerën e drejtë të këtyre shënimeve vazhdon të grumbullohet në rezervën e rivlerësimit të investimit derisa ato të ç'regjistrohen ose riklasifikohen;
- pasuritë financiare të klasifikuara si të mbajtura deri në maturim dhe kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme sipas SNK 39 që janë matur me koston e amortizuar vazhdojnë të maten me koston e amortizuar sipas SNRF 9 pasi ato mbahen në një model biznesi për të mbledhur rrjedha kontraktuale të pasurisë dhe këto rrjedha të pasurisë përbëhen vetëm nga pagesat e principalit dhe të interesit për shumën e principalit të papaguar.

Asnjë nga riklasifikimet e pasurive financiare nuk ka pasur ndonjë ndikim në gjendjen financiare të Bankës dhe rezervat kumulative më 1 janar 2018.

2.3.1.2 Ndryshimet në llogaritjen e rënies në vlerë

Në lidhje me rënien në vlerë të pasurive financiare, SNRF 9 kërkon një model humbjeje të pritshme kundrejt një modeli të humbjes kreditore të shkaktuar sipas SNK 39. Modeli i pritshëm i humbjes kreditore kërkon që Banka të llogarisë humbjet e pritshme kreditore dhe ndryshimet në ato humbje të pritshme kreditore në çdo datë raportimi për të pasqyruar ndryshimet në riskun kreditor që nga njohja fillestare e pasurive financiare. Me falje të tjera, nuk është më e nevojshme për një ngjarje kreditore të ndodh para se të njihen humbjet kreditore.

Në mënyrë të veçantë, SNRF 9 kërkon që Banka të njohë një lejim të humbjes për humbjet e pritshme të kreditore për:

- Investimet e borxhit të matura më pas me koston e amortizuar ose në VDPATGJ;
- Të arkëtueshmet e qirasë;
- Të arkëtueshmet tregtare dhe pasuritë e kontraktuara; dhe
- Kontratat e garancioneve financiare për të cilat zbatohen kërkesat për rënien në vlerë të SNRF 9.

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.3 Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara (vazhdim)

2.3.1 SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)

2.3.1.2 Ndryshimet në llogaritjen e provizionit (vazhdim)

Në veçanti, SNRF 9 kërkon që Banka të masë lejimin e humbjes për një instrument financiar në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore (HPK) të përhershme, nëse risku kreditor për atë instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare ose nëse instrumenti financiar është një pasuri financiare e blerë ose e gjenur nga rënia në vlerë kreditore.

Megjithatë, nëse risku kreditor për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare (përveç një pasurie financiare të blerë ose një pasurie financiare të gjenur nga rënia në vlerë kreditore), Banka duhet të matë lejimin për humbjen për atë instrument financiar në një shumë të barabartë me HPK12 mujore. SNRF 9 gjithashtu kërkon një metodë të thjeshtuar për matjen e lejeve të humbjeve në një shumë të barabartë me HPK të përhershme për të arkëtueshmet tregtare, pasuritë e kontraktuara dhe të arkëtueshmet e qirasë në rrethana të caktuara, megjithatë Banka nuk ka pasuri domethënëse që i nënshtrohen kësaj kategorie.

Shtesa e lejimit të humbjes kreditore prej 1,870 mijë Euro më 1 janar 2018 është njohur kundrejt fitimit të akumuluar në të njëjtën datë, pa ndikimin e tatimit të shtyrë prej 187 mijë Euro, duke rezultuar në uljen neto të fitimeve të akumuluar prej 1,683 mijë Euro në 1 Janar 2018. Shtesa e lejimit të humbjeve është ngarkuar ndaj pasurisë ose provizionit përkatës për garancione financiare, përveç investimeve në instrumentet e borxhit të qeverisë, të cilat maten me VDPATGJ, lejimi i humbjeve për të cilat njihet kundrejt rezervës së rivlerësimit të investimit.

2.3.2 SNRF 7R

Për të pasqyruar ndryshimet ndërmjet SNRF 9 dhe SNK 39, SNRF 7 *Instrumentet Financiare: Shpalosjet* janë përditësuar dhe Banka e ka adaptuar atë së bashku me SNRF 9 për vitin që fillon më 1 janar 2018. Ndryshimet përfshijnë shpalosjet e tranzicionit siç paraqitet në Shënimin 6, informacion cilësor dhe sasior në lidhje me llogaritjet HPK sikurse supozimet dhe inputet e përdorura që janë paraqitur në Shënimin 27. Barazimi nga hapja në mbyllje i lejeve për HPK është paraqitur në Shënimin 16. SNRF 7R gjithashtu kërkon shpalosje shtesë dhe më të detajuara për kontabilitetin mbrojtës edhe për subjektet që kanë zgjedhur të vazhdojnë të zbatojnë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës të SNK 39.

2.3.3 SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët

SNRF 15 zëvendëson të gjitha kërkesat ekzistuese të të hyrave në SNRF (SNK 11 Kontratat e Ndërtimit, SNK 18 Të Ardhurat, IFRIC 13 Programet e Besnikërisë së Klientit, IFRIC 15 Marrëveshjet për Ndërtimin e Pasurive të Paluajtshme, IFRIC 18 Transferet e Pasurive nga Konsumatorët dhe SIC 31 Të Hyrat – Transaksionet e Shkëmbimit që Përfshijnë Shërbimet e Reklamimit) dhe zbatohet për të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga kontratat me klientët, me përjashtim të rasteve kur kontratat janë në fushëveprimin e standardeve të tjera, siç janë SNK 17 Qiratë (ose SNRF 16 Qiratë, prej aplikimit). Kërkesat gjithashtu sigurojnë një model për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve në dispozicion të disa pasurive jofinanciare, duke përfshirë pasuritë afatgjata materiale, ndërtesat dhe pajisjet dhe pasuritë të paprekshme. Duke qenë se fokusi i SNRF 15 nuk është kontabilizimi i të ardhurave nga instrumentet financiare të cilat në rastin e Bankës trajtohen sipas SNRF 9, atëherë numri i kontratave për të cilat standardi është i aplikueshëm është shumë i kufizuar. Banka nuk kishte asnjë ndikim nga zbatimi i SNRF 15.

Banka adaptoi SNRF 15 duke përdorur metodën retrospektive të adaptimit me datën e zbatimit fillestar 1 janar 2018. Banka zgjodhi të zbatojë standardin për të gjitha kontratat më 1 janar 2018. Informacioni krahasues nuk është riparaqitur dhe vazhdon të raportohet sipas SNK 18 dhe interpretimet përkatëse.

SNRF 15 kryesisht përfshinë brenda fushëveprimit të saj të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet të Bankës (Shënim 8). Këto tarifa dhe komisione normalisht fitohen kur transaksionet ekzekutohen ose janë tarifat e aplikuar për mirëmbajtjen e llogarive brenda një muaji ose viti dhe zakonisht përbushen detyrimet e performancës dhe të ardhurat e njohura brenda vitit financiar.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)
2.3 Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara (vazhdim)
2.3.3 SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët (vazhdim)

Shitja e kolateraleve të riposëduara gjithashtu bie nën SNRF 15. Të ardhurat nga këto shitje njihen kur risku dhe përfitimet e pasurisë transferohen tek blerësi, edhe nëse titulli i pronësisë ruhet si garancion për kryerjen e pagesave.

Nuk ka rrjedhje të tjera të hyrave materiale që përfshihen në SNRF 15 dhe miratimi i këtij standardi nuk ka ndryshuar praktikën e njohjes së të ardhurave të Bankës.

2.4 Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro e cila është valutë funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rumbullaksuar në mijëshen më të afërt përveç kur ceket ndryshe.

2.5 Shifrat përkatëse

Shifra përkatëse të caktuara janë riklasifikuar në mënyrë që të jenë në përputhje me bazën e prezantimit të vitit aktual.

- Në të ardhurat nga tarifat dhe komisionet janë përfshirë disa kategori të interesit nga transferet e pagesave dhe transaksionet në shumën totale prej 37 mijë Euro (2017: 10 mijë Euro) të cilat janë klasifikuar më parë nën të ardhurat nga interesi në shënimin 7.
- Shpenzimet e sigurimit të depozitave në vlerë prej 367 mijë Euro (2017: 271 mijë Euro) është riklasifikuar nga shpenzimet e interesit shënim 7, tek shpenzimet tjera operative shënim 10 në zërin Sigurimi dhe siguria fizike.

2.6 Përdorimi i gjyimeve dhe i vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, menaxhmenti ka bërë gjyime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe mbi shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të kenë ndryshime nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacionet mbi elementët e rëndësishëm me pasiguri në vlerësime dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël me efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 4, 5 dhe 27.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

a) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Sipas SNRF 9 dhe SNK 39 të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. 'Norma efektive e interesit' është norma që saktësisht diskonton pagesat ose arkimet e ardhshme në para të gatshme nëpërmjet jetës së pritshme të instrumentit financiar (ose, sipas rastit, një periudhe më të shkurtër) në:

- vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhat e ardhshme të parasë duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar por jo humbjet e ardhshme kreditore. Për pasuritë financiare të rena në vlerë, një normë efektive e interesit të rregulluar nga kredia llogaritet duke përdorur rrjedhat e ardhshme të vlerësuar të parasë duke përfshirë humbjet e pritshme kreditore.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)
a) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi (vazhdim)

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshinë të gjitha kostot e transaksionit të tarifave dhe komisionet dhe zbritjet e tjera të paguara ose pranuar, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo emetimin e një pasurie apo detyrimi financiar.

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit zbatohet në vlerën kontabël bruto të pasurive (kur pasuritë nuk janë të rena në vlerë) ose në koston e amortizuar të detyrimit.

Sidoqoftë, sipas SNRF 9 për pasuritë financiare që kanë pasur rënie në vlerën kreditore pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar të pasurisë financiare. Nëse pasuria nuk është më e rënë në vlerën kreditore, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi rikthehet në bazë bruto.

Sipas SNRF 9 për pasuritë financiare të cilat kanë rënë në vlerën kreditore në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit të rregulluar nga kredia në koston e amortizuar të pasurisë. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në baza bruto, edhe nëse risku kreditor i pasurisë përmirësohet.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e ardhurave tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë:

- interesin nga pasuri ose detyrime financiare matur me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv; dhe
- interesi nga instrumentet e borxhit në VDATGJ të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

b) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit në një pasuri, detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Sipas SNRF 15 Banka fiton të ardhura nga tarifat dhe komisionet nga një gamë e larmishme e shërbimeve financiare që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet njihen në një shumë që reflekton shumën në të cilën Banka pret që të ketë të drejtë në këmbim të ofrimit të shërbimeve.

Detyrimet e performancës, si dhe kohëzgjatja e plotësimit të tyre, identifikohen dhe përcaktohen në fillim të kontratës. Kontratat e të ardhurave të Bankës zakonisht nuk përfshijnë detyrime të shumta të performancës.

Shërbimet që Banka ofron për klientët e saj, duhet të paguhën menjëherë pas përbushjes së një shërbimi në një moment të caktuar.

Banka në përgjithësi ka konkluduar se janë thelbësore kontratat e saj të të ardhurave sepse zakonisht i kontrollon shërbimet përpara se t'i transferojë ato tek klienti.

Sipas SNK 18 të ardhura e tjera nga tarifat dhe komisionet, përfshirë edhe tarifat e shërbimeve të llogarive, tarifat e transferimit të fondeve si dhe komisionet e shitjeve dhe tarifa për vendosje me afat në Banka, njihen me kryerjen e shërbimeve të lidhura me to. Kur një angazhim për kreditim nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e kredisë, komisionet e kredisë përkatëse njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së angazhimit.

Shpenzimet e tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.

c) Pagesat e qirasë

Pagesat për qiranë operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Zbritjet nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit për qira, përgjatë afatit të qirasë.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)
d) Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në ekuitet ose në pasqyrën e të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshinë tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat ose humbjet e tatueshme për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme që dalin midis bazës tatimore dhe vlerës kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve në pasqyra financiare. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme që lindin me rastin e njohjes fillestare të pasurive ose detyrimeve të transaksioneve që nuk përbëjnë një kombinim biznesi dhe që nuk ndikojnë as në fitimin, as në humbjen kontabël dhe as në atë të tatueshme.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do ta përcjellin mënyrën në të cilën Banka pret në fund të periudhës raportuese që të mbulojë apo vendosë vlerën kontabël të mjeteve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë matet sipas normave tatimore që priten të aplikohen në diferencat e përkohshme kur ato kthehen, përmes normave tatimore në fuqi në datën e raportimit.

Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen ndërmjet tyre nëse ka një të drejtë ligjore për ta kompensuar me njërin dhe detyrimin e tatimit dhe kur ndërlihen me tatimet e pagueshme kundrejt autoritetit të njëjtë tatimor.

Tatimet shtesë që vijnë si rezultat i shpërndarjes së dividendës nga ana e Bankës njihen në të njëjtën kohë kur edhe njihen detyrimet për ta paguar dividendën respektive.

Një pasuri tatimore e shtyrë njihet për humbjet sipas tatimeve, kredive tatimore dhe dallimet e përkohshme të zbritshme të pasqyrës, vetëm në atë masë që është e mundur të shfrytëzohet për fitimet e ardhshme të tatueshme kundër të cilave mund të shfrytëzohet kjo pasuri. Pasuritë e tatimit të shtyrë rishikohen në secilën datë të raportimit dhe redukohen në atë masë që nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen.

(iii) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me adekuatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

e) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj rivlerësohen në valutën funksionale përkatëse të Bankës me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet në valutë të huaj në datën e raportimit konvertohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit të asaj date.

Fitimi ose humbja nga zërat monetar është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutë funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës si dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj me kursin e këmbimit në fundin e vitit.

Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në valutë të huaj që maten me vlerën e drejtë janë konvertuar në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në valutë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga rivlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)
f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme pas 1 janar 2018)
(i) Njohja

Banka fillimisht një kreditë dhe paradhënit, depozitata, instrumentet e borxhit, huamarrjet dhe kreditë e varura në datën që ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet e tjera financiare (duke përfshirë blerjet dhe shitjet e pasurive financiare në mënyrë të rregullt) njihen fillimisht në datën e tregimit, e cila është data kur Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

(ii) Klasifikimi
Pasuritë financiare

Në njohjen fillestare, një pasuri financiare klasifikohet si e matur me: koston e amortizuar, VDATGJ ose VDPFH. Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- pasuritë mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e pasurive për mbledhjen e rrjedhave kontraktuale të parasë; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiar japin datat e përcaktuara në rrjedhat e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar.

Një instrument borxhi matet në VDATGJ vetëm nëse plotëson të dyja këto kushte dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- pasuritë mbahen brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit arrihet si nga mbledhja e rrjedhat kontraktuale të parasë dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiar japin datat e përcaktuara në rrjedhat e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar.

Për njohjen fillestare të një investimi kapital që nuk mbahet për shitje, Banka mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë në ATGJ. Kjo zgjedhje bëhen në bazë të investimeve për investime.

Të gjitha pasuritë financiare klasifikohen si të matura me koston e amortizuar ose në VDATGJ.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Banka bën një vlerësim të objektivit të një modeli biznesi në të cilin një pasuri është mbajtur në një nivel të portofolit, sepse kjo më së miri reflekton mënyrën se si menaxhohet biznesi dhe i jepet informacioni menaxhmentit. Informacioni i konsideruar përfshinë:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimin e këtyre politikave në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e menaxhmentit fokusohet në fitimin e të ardhurave nga interesi kontraktual, duke ruajtur një profil të caktuar të normës së interesit, duke përpunuar kohëzgjatjen e pasurive financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë ato pasuri ose realizimin e rrjedhës së parasë nëpërmjet shitjes së pasurive;
- si vlerësohet dhe raportohet performanca e portofolit të menaxhmentin e Bankës;
- risqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe pasuritë financiare të mbajtura brenda modelit të biznesit) dhe si menaxhohen ato risqe;
- se si menaxherët e biznesit janë kompensuar - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të pasurive të administruara ose rrjedhat së parasë kontraktuale të mbledhura; dhe
- frekuenca, vëllimi dhe koha e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për shitjet e tilla dhe pritsëmëritë e tij për aktivitetin e ardhshëm të shitjes. Megjithatë, informacioni rreth aktivitetit të shitjeve nuk konsiderohet veç e veç, por si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm se si është arritur objektiv i Bankës për menaxhimin e pasurive financiare dhe si realizohen rrjedha të parasë.

Banka nuk mban ndonjë pasuri financiare që mbahet për tregtim ose menaxhim dhe performanca e të cilave vlerësohet sipas VDPFH.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)
f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme pas 1 janar 2018) (vazhdim)
(ii) Klasifikimi (vazhdim)
Pasuritë financiare (vazhdim)
Vlerësimi nëse rrjedhat kontraktuale të parasë janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit

Për qëllimet e këtij vlerësimi, 'principal' përcaktohet si vlera e drejtë e pasurisë financiare në njohjen fillestare. 'Interesi' përcaktohet si një shpërblim për vlerën kohore të parasë dhe për riskun kreditor që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për risiqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. risku i likuiditetit dhe kostot administrative) si dhe për marzhën e fitimit.

Në vlerësimin nëse rrjedhat kontraktuale të parasë janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, Banka konsideron kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshinë vlerësimin nëse pasuritë financiare përmbajnë një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e rrjedhat kontraktuale të parasë në mënyrë që ajo të mos plotësojë këtë kusht. Gjatë marrjes së vlerësimit, Banka konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që do të ndryshonin sasinë dhe kohën e rrjedhave të parasë ;
- karakteristikat e borxhit;
- parapagimi dhe afatet e zgjatjes;
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Bankës për rrjedhat e parasë nga pasuritë e specifikuar; dhe
- karakteristika që ndryshojnë konsideratën për vlerën kohore të parasë - p.sh. rivendosjen periodike të normave të interesit.

Banka ka një portofol kredie afatgjatë me normë fikse për të cilën Banka ka mundësi të propozojë rishikimin e normës së interesit në datat e rivendosjes periodike. Këto të drejta të rivendosjes janë të kufizuara në normën e tregut në kohën e rishikimit. Huamarrësit kanë një mundësi që të pranojnë normën e rishikuar ose të shlyejnë huanë në parim pa dënim. Banka ka përcaktuar që rrjedhat kontraktuale të parasë të këtyre kredive janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit sepse opsioni ndryshon normën e interesit në një mënyrë që është konsideratë për vlerën kohore të parasë, riskun e kredisë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe kostot që lidhen me shumat kryesore të paguara.

Riklasifikimet

Pasuritë financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën pas ndryshimit të modelit të biznesit të saj për menaxhimin e pasurive financiare.

Detyrimet financiare (Politika e aplikueshme para ose pas 1 janarit 2018)

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare si të matura me koston e amortizuar.

(iii) Ç'regjistrimi
Pasuritë financiare

Banka regjistron një pasuri financiare kur mbarojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhjet e parave nga pasuria financiare ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhje të parave kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha risiqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar ose në të cilat Banka as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për ç'regjistrim që është krijuar apo mbajtur nga Banka njihet si një pasuri ose detyrim në vetë.

Në momentin e ç'regjistrimit të një pasurie financiare, diferenca mes vlerës kontabël neto të pasurisë (ose vlera kontabël që i përket pjesës së pasurisë së transferuar), dhe totalit të (i) konsideratës së marrë (përfshirë çdo pasuri të re të përfituar ose detyrim të supozuar) dhe (ii) çdo fitimi ose humbje kumulative që është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, njihet në fitim ose humbje.

Banka hyn në transaksione me të cilat transferon pasuritë e njohura në pasqyrën e saj të pozicionit financiar, por ruan të gjitha ose në thelb të gjitha risiqet dhe përfitimet e pasurive të transferuara ose një pjesë të tyre. Në raste të tilla, pasuritë e transferuara nuk ç'registrohen. Shembuj të transaksioneve të tilla janë huatë e letrave me vlerë të transaksionet e shitjes dhe riblerjes.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)
f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme pas 1 janar 2018) (vazhdim)
(iii) Ç'regjistrimi (vazhdim)
Pasuritë financiare (vazhdim)

Kur pasuritë i shiten një pale të tretë me një normë totale të kthimit në pasuritë e transferuara, transaksioni trajtohet si një transaksion financimi i siguruar, i ngjashëm me transaksionet e shitjeve dhe të riblerjes, sepse Banka mban të gjitha ose në thelb të gjitha risqet dhe shpërblimet e pronësisë së këtyre pasurive.

Në transaksionet në të cilat Banka nuk ruan ose transferon në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë së një pasurie financiare dhe mban kontrollin mbi pasurinë, Banka vazhdon të njohë pasurinë deri në masën e përfshirjes së saj të vazhdueshme, të përcaktuar sipas masës për të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e pasurisë së transferuar.

Detyrimet financiare (Politika e aplikueshme para ose pas 1 janar 2018)

Banka ç'registron një detyrim financiar kur obligimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose kanë përfunduar.

(iv) Ndryshimet e pasurive dhe detyrimeve financiare

Nëse kushtet e një pasurie financiare ndryshohen, Banka vlerëson nëse rrjedhat kontraktuale të parasë të pasurisë së modifikuar janë në thelb të ndryshme. Nëse rrjedhat e parasë janë substancialisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale në rrjedhat e parasë nga pasuria financiare fillestare, konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, pasuritë financiare origjinale ç'registrohen dhe një pasuri financiare e re njihet me vlerën e drejtë.

Nëse rrjedhat e parasë së pasurisë së modifikuar të bartur me koston e amortizuar nuk janë në thelb të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrimin e pasurisë financiare. Në këtë rast, Banka rrikalkulon vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare dhe një shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje e modifikuar në fitim ose humbje. Nëse një ndryshim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga rënia në vlerë. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhura nga interesi.

(v) Netimi (Politika e aplikueshme para dhe pas 1 janar 2018)

Pasuritë dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë, dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë ato në një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, apo për fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup i transaksioneve të ngjashme sikurse nga aktiviteti komercial i bankës.

(vi) Matja me kosto të amortizuar

'Kosto e amortizuar' e një pasurie ose detyrimi financiar është vlera me të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, dhe për pasuritë financiare të rregulluara për ndonjë zbritje të prishme të humbjes nga kreditë. "Vlera kontabël bruto e një pasurie financiare" është kostoja e amortizuar e një pasurie financiare përpara se të korrigjohet për çdo zbritje të humbjes së prishme kreditore.

(vii) Matja e vlerës së drejtë (Politika e aplikueshme para ose nga 1 janar 2018)

'Vlera e drejtë' është çmimi me të cilin pasuria mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun me të favorshëm ku Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron riskun e mosekzekutimit të tij.

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme pas 1 janar 2018) (vazhdim)

(vii) Matja e vlerës së drejtë (Politika e aplikueshme para ose nga 1 janar 2018) (vazhdim)

Kur është e mundur, Banka përcakton vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në tregun aktiv për instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me pasurinë apo detyrimin ndodhin shumë shpesh dhe me volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm për çmimin.

Kur nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshinë gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar me njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit –për shembull; vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një pasuri apo detyrim identik, e as nuk është e bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet të vrojtueshme në treg, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, i rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë është njohur në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se vlerësimi që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.

Nëse një pasuri ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka çmim të ofruar dhe çmim të kërkuar, Banka matë pasuritë dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmim të kërkuar.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma që paguhet në momentin e kërkesës, e cila zbritet nga data e parë kur mund të kërkohej pagesa e depozitës.

Banka njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ky ndryshim (shënim 5).

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Banka njeh provizionet e humbjeve për HPK për instrumentet financiare të mëposhtme që nuk maten me VDPFH:

- pasuritë financiare që janë instrumente borxhi; dhe
- zotimet e kredive dhe kontratat e garancioneve financiare të lëshuara (më parë, rënia në vlerë është matur sipas SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente).

Banka do të njohë provizionet e humbjeve në një shumë të barabartë me HPK-të e përhershme, përveç rasteve të mëposhtme, për të cilat shuma e njohur do të jetë HPK12 mujore:

- investimet në letrat me vlerë të borxhit që përcaktohen të kenë risk të ulët të kredisë në datën e raportimit. Banka e konsideron një siguri të borxhit të ketë risk të ulët të kreditor kur vlerësimi i riskut të tij kreditor është i barabartë me përkufizimin e kuptimit global të 'klasës së investimit'; dhe
- kreditë dhe investimet në letrat me vlerë të borxhit për të cilat risku kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme pas 1 janar 2018) (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Matja e HPKs

HPK janë një vlerësim i ponderuar i probabilitetit të humbjeve kreditore dhe do të maten si më poshtë:

- pasuritë financiare që nuk janë të rëna në vlerë në datën e raportimit: vlera aktuale e të gjitha humbjeve në mjete monetare - d.m.th. Diferenca midis rrjedhave të parasë që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe rrjedhat e parasë që Banka pret të marrë;
- pasuritë financiare që janë të rëna në vlerë në datën e raportimit: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të rrjedhave të parasë të ardhshme të vlerësuar;
- zotimet e kredive: vlera aktuale e diferencës ndërmjet rrjedhave kontraktuale të parasë që i detyrohen Bankës nëse tërheqja e zotimit dhe rrjedhat e parasë që Banka pret të marrë; dhe
- kontratat e garancioneve financiare: vlera aktuale e pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin minus shumat që Banka pret të kthejë.

Përkufizimi i vonesave

Sipas SNRF 9, Banka do të konsiderojë një pasuri financiare në vonesë kur:

- huamarrësi nuk ka gjasë të paguajë detyrimet e tij të kredisë në Bankë në tërësi, pa pasur nevojë nga ana e Bankës për veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- Huamarrësi ka më shumë se 90 ditë të kaluara për çdo detyrim material kredie për Bankën.

Ky përkufizim është kryesisht në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime rregullatore për kreditë e klasifikuara si të dyshimta ose humbje (shih Shënimin 3 (vii)).

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në vonesë, Banka do të konsiderojë që treguesit janë në përputhje me kërkesat rregullatore të riskut për klasifikimin e huave si të dyshimta ose të humbura:

- cilësore: p.sh. shkeljet e kovenantave kontraktuale;
- sasiorë: p.sh. statusi i vonuar dhe mos pagesa e një detyrimi tjetër të të njëjtit huamarrës në Bankë; dhe
- klasifikimi rregullator i riskut të huamarrësve të njëjtë në banka të tjera.

Inputet në vlerësimin nëse një instrument financiar është në vonesë dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të reflektuar ndryshimet.

Nivelet e riskut kreditor

Banka vendos çdo ekspozim në një klasë të riskut kreditor bazuar në kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e Menaxhimit të Riskut të Kredisë duke përdorur faktorë cilësorë dhe sasiorë që tregojnë riskun e vonesave. Krahës klasave të riskut të prezantuara për qëllime rregullatore, Banka identifikon dhe monitoron veçmas kreditë standarde në vonesë nga kreditë standarde jo në vonesë.

Çdo ekspozim do të alokohet në një klasë të riskut kreditor për njohjen fillestare bazuar në informacionin në dispozicion për huamarrësin. Ekspozimet do t'i nënshtrohen monitorimit të vazhdueshëm, gjë që mund të rezultojë në një ekspozim të zhvendosur në një klasë të riskut kreditor.

Rritja e ndjeshme të riskut kreditor

Rritja e ndjeshme e riskut të vonesave dhe vonesat vetë janë përcaktuesit kryesorë për llogaritjen e humbjeve të pritshme të kredisë.

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ka pasur një rritje të ndjeshme në riskun kreditor duke krahasuar: (i) riskun që kredia do të jetë në vonesë në datën e raportimit ose pas datës së raportimit dhe (ii) riskun e vonesave të vlerësuar në ose pas datës së njohjes së saj fillestare.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)
f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme pas 1 janar 2018) (vazhdim)
(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)
Rritja e ndjeshme të riskut kreditor (vazhdim)

Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Banka konsideron informata të arsyeshme dhe të mbështetshme për hua individuale ose grupe kredish kur informacioni i arsyeshëm dhe i mbështetur nuk është i disponueshëm në baza individuale. Matja e modelit HPK pasqyron modelin e përgjithshëm të përkeqësimit ose përmirësimit të cilësish së kredisë së instrumenteve financiare, shprehur në aspektin e rritjes së ndjeshme të riskut kreditor. Kur instrumenti financiar fillimisht gjenerohet, lejimi i humbjeve matet në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme 12-mujore të kredisë. Kur risku i vonësive të instrumentit është rritur ndjeshëm që nga krijimi i tij, Banka do të masë lejimin e humbjeve në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të përhershme të kredisë.

Banka do të monitorojë efektivitetin e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme në riskun kreditor, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se:

- kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme në riskun kreditor para se një ekspozim të jetë në vonës;
- koha mesatare në mes të identifikimit të një rritjeje të konsiderueshme të riskut kreditor dhe vonësës të duket e arsyeshme; dhe
- ekspozimet në përgjithësi nuk transferohen drejtpërdrejt nga matja HPK 12-mujore ndaj rënies në vlerë të kredisë.

Përcaktimi nëse risku kreditor është rritur ndjeshëm

Sipas SNRF 9, kur përcaktohet nëse risku kreditor (d.m.th. risku i vonësës) për një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Banka do të konsiderojë informata të arsyeshme dhe të mbështetshme që janë relevante dhe të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme, informacion cilësor dhe analiza bazuar në përvojën historike të Bankës, vlerësimin e kredive të ekspertëve dhe informacionin e ardhshëm.

Banka do të identifikojë kryesisht nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e riskut kreditor për një ekspozim që ndryshon klasifikimin e riskut rregullator nga standardi për tu shikuar në përputhje me politikën e Bankës për klasifikimin e riskun rregullator. Të gjitha kreditë që shfaqin rritje të ndjeshme në riskun kreditor klasifikohen në Kategorinë 2.

Si një rezervë, dhe siç kërkohet nga SNRF 9, Banka me gjasë do të konsiderojë se një rritje e ndjeshme e riskut kreditor ndodh jo më vonë se kur një pasuri është më shumë se 30 ditë në vonës. Banka do të përcaktojë ditët e kaluara duke numëruar numrin e ditëve që nga data më e hershme e kaluar për të cilën pagesa e plotë nuk është pranuar.

Si një rezervë tjetër, Banka do të konsiderojë si një rritje e ndjeshme e riskut kreditor, nëse kredia klasifikohet nga standardi në ndjekje ose në një klasë më të keqe të riskut ose kreditë e tjera të të njëjtit klient me Bankën janë klasifikuar nga standardi në ndjekje ose në një shkallë më keq të riskut. Banka gjithashtu do të konsiderojë që risku është rritur nëse klienti kërkon një ristrukturim me masa lehtësuese siç janë: maturimi i zgjidhur, kësti më i ulët, norma e interesit më e ulët, përjashtimet nga ndëshkimet dhe interesi i akumuluar.

Grupimi i kredive
Vlerësimi i përgjithshëm i probabilitetit të dështimit (PD)

Për qëllime të një vlerësimi të përgjithshëm të PD-së, BPB grupon kreditë në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut kreditor që janë tregues i aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat e duhura sipas kushteve kontraktuale.

Duke marrë parasysh profilin e riskut kreditor për kreditë e saj, BPB ka zgjedhur të grupojë kreditë në bazë të **tipit të klientit** (bizneset e mëdha dhe të mesme, bizneset e vogla, individët) dhe **llojit të produktit** (biznesore, hipotekare, konsumuese).

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)
f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme pas 1 janar 2018) (vazhdim)
(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)
Grupimi i kredive (vazhdim)
Vlerësimi i përgjithshëm i probabilitetit të dështimit (PD) (vazhdim)

Ekziston një segmentim i portofolit të kredisë bazuar në karakteristikat e ngjashme të riskut. Më poshtë janë paraqitur shtatë segmente të portofolit të kredisë dhe të kartave të kreditit:

- Korporatë
- Mikro
- Agro
- Hipotekare
- Veteranët & Invalidët
- Konsumuese
- Kartat e kreditit

Vlerësimi i përgjithshëm i kredive në dështim (KND)

Për qëllime të vlerësimit të përgjithshëm të KND-ve, kreditë janë grupuar në bazë të:

- ciklit të rikuperimit të mjeteve monetare për kreditë joperformuese;
- lloji i kolateralit (d.m.th. kolaterali i pasurive të paluajtshme); dhe
- kthimi pas shlyerjeve.

BPB shqyrton në baza vjetore kufijtë dhe kriteret e përcaktuara për të siguruar që ato mbeten të vlefshme pas ndryshimeve të mundshme në madhësinë dhe përbërjen e portofolit të kredive.

Pasuritë financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të ndryshohen për një numër arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, mbajtjen e klientëve dhe faktorëve të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim të tanishëm ose potencial të kredisë së klientit. Një kredi ekzistuese, kushtet e të cilave janë modifikuara, mund të ç'regjistrohen dhe kredia e rinegociuar të njihet si një kredi e re me vlerë të drejtë.

POCI: Pasuritë e blera ose të gjeneruara nga rënia në vlerë (POCI) janë pasuritë financiare që kanë rënë në vlerë në njohjen fillestare. Këto pasuri regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një EIR të rregulluar nga kredia. HPK-të njihen vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritshme të kredisë. Për pasuritë financiare për të cilat Banka nuk ka shpresa të arsyeshme për mbulimin e të gjithë shumës së mbetur, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e pasurisë financiare zvogëlohet. Kjo konsiderohet një çregjistrim (i pjesëshëm) i pasurisë financiare.

Sipas SNRF 9, kur kushtet e një pasurie financiare ndryshohen dhe modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim, Banka do të shqyrtojë nëse risku kreditor së pasurive është rritur ndjeshëm duke analizuar faktorët sasiorë dhe cilësorë që ndikojnë në riskun e dështimit.

Banka rinegocion kredi për klientët në vështirësi financiare (të referuara si 'aktivitete të ristrukturimit') për të maksimizuar mundësitë e grumbullimit dhe minimizuar riskun e dështimit. Sipas politikës së ristrukturimit të bankës, ristrukturimi i kredisë jepet në baza selektive nëse debitori momentalisht është në vonës të borxhit të tij ose nëse ka një risk të lartë të vonësës, ka dëshmi se debitori ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të paguar sipas kontratës fillestare kushtet dhe debitori pritet të jetë në gjendje të përmbushë kushtet e rishikuara.

Termat e rishikuar zakonisht përfshijnë zgjatjen e maturitetit, ndryshimin e kohës së pagesave të interesit dhe ndryshimin e kushteve të kovenantatave të kredisë. Kreditë inviduale dhe biznesore janë subjekt i politikës së ristrukturimit.

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme pas 1 janar 2018) (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Pasuritë financiare të modifikuara (vazhdim)

Në përgjithësi, ristrukturimi është një tregues cilësor i vonës dhe rënies në vlerën kreditore dhe pritjet e ristrukturimit janë të rëndësishme për të vlerësuar nëse ka një rritje të konsiderueshme të riskut kreditor. Pas ristrukturimit, një klient duhet të tregojë sjellje të mirë të pagesave në mënyrë të qëndrueshme gjatë të të muajve para se ekspozimi të matet në një shumë të barabartë me HPK-të 12-mujore.

Inputet në matjen e HPK

Inputet kryesore në matjen e HPK-ve ka të ngjarë të jenë struktura e termave të variabla ve në vijim:

- probabiliteti i dështimit (PD);
- kreditë në dështim (KND); dhe
- ekspozimi në dështim (END).

Këta parametra do të rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara brenda vendit dhe të dhëna të tjera historike që përdorin modelet rregullatore. PD-të do të rregullohen për të pasqyruar informacionin e ardhshëm si më poshtë.

Nivelet e riskut kreditor do të jenë një input primar në përcaktimin e strukturës së afateve të PD për ekspozimet. Banka do të përdorë modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të gjeneruar vlerësime të PD të jetës së mbetur të ekspozimeve si dhe këto pritjet të ndryshojnë si pasojë e kalimit të kohës.

Kjo analizë do të përfshijë identifikimin dhe kalibrimin e marrëdhënieve ndërmjet ndryshimeve në normat e vonuara dhe ndryshimet në faktorët kryesorë makroekonomikë, si dhe analizën e thellë të ndikimit të disa faktorëve të tjerë (p.sh. përvojën e ristrukturimit) në riskun e vonës. Për shumicën e ekspozimeve, treguesit kryesorë makroekonomikë ka të ngjarë të përfshijnë rritjen e GDP-së, normat e interesit dhe papunësinë. Qasja e Bankës për përfshirjen e informacioneve të ardhshme në këtë vlerësim është diskutuar më poshtë.

KND është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka vonesa. Banka do të vlerësojë parametrat KND bazuar në historinë e normave të rikuperimit të kërkesave ndaj palëve të kundërta. Modelet KND do të konsiderojnë strukturën, kolateralin, vjetërsinë e kërkesës dhe kostot e rimëkëmbjes së çdo kolaterali që është pjesë përbërëse e pasurive financiare. Për kreditë e siguruar nga prona me pakicë, raportet e kredisë për vlerën (KPV) ka të ngjarë të jenë një parametër kyç në përcaktimin e KND.

Vlerësimet KND do të kalibrohen për skenarë të ndryshëm ekonomikë dhe, për huadhënien e pasurive të paluajtshme, të pasqyrojnë ndryshimet e mundshme në çmimet e pronës. Ato do të llogariten në bazë të rrjedhës së parastë të diskontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor diskontues.

END përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një vonese. Banka do të nxjerr END nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës, përfshirë amortizimin dhe parapagimet. END e një pasurie financiare do të jetë vlera kontabël bruto në vonesë. Për angazhimet e huadhënies dhe garancionet financiare, END do të shqyrtojë shumën e tërhequr, si dhe shumat potenciale të ardhshme që mund të tërhiqen ose paguhen sipas kontratës, të cilat do të vlerësohen bazuar në vërtetimet historike dhe parashikimet e ardhshme.

Banka do të matë HPK-të duke marrë në konsideratë riskun e vonës për periudhën maksimale kontraktuale (duke përfshirë opsionet e zgjerimit të huamarrësit) mbi të cilat ai është i ekspozuar ndaj riskut kreditor, edhe nëse për qëllime të administrimit të riskut Banka konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Banka ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie ose të përfundojë një angazhim kredie apo garancion.

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme pas 1 janar 2018) (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e provizioneve (vazhdim)

Inputet në matjen e HPK (vazhdim)

Për mbështetjet individuale dhe kartelat kreditore dhe disa produkte kreditore biznesore që përfshijnë si një kredi dhe një element të zotimit të patërhequr, Banka do të matë HPK-të për një periudhë më të gjatë se periudha maksimale kontraktuale, nëse aftësia kontraktuale e Bankës për të kërkuar shlyerjen dhe anulimin e zotimit të patërhequr nuk e kufizon ekspozimin e Bankës ndaj humbjeve të kredisë në periudhën e njohimit kontraktual. Këto produkte nuk kanë një afat të caktuar ose strukturë të ripagimit dhe menaxhohen në baza kolektive. Banka mund t'i anulojë ato me efekt të menjëhershëm, por kjo e drejtë kontraktuale nuk zbatohet në menaxhimin normal të përditshëm, por vetëm kur Banka të dijë për një rritje të riskut kreditor në nivel të produktit. Kjo periudhë më e gjatë do të vlerësohet duke marrë parasysh veprimet e menaxhimit të riskut kreditor që Banka pret të ndërmarrë dhe që shërbejnë për të zbutur HPK-të. Këto përfshijnë një ulje të limiteve dhe anulimin e produkteve.

Kur modelimi i një parametri kryhet në baza kolektive, instrumentet financiare do të grupohen në bazë të karakteristikave të përbashkëta të riskut që përfshijnë:

- loji i instrumentit; dhe
- klasifikimi i riskut kreditor.

Grupimi do t'i nënshtrohet rishikimit të rregullt për të siguruar që ekspozimet brenda një grupi të veçantë të mbeten në mënyrë të përshtatshme homogjene.

Për investimet në letrat me vlerë të borxhit në lidhje me të cilat Banka ka të dhëna të kufizuara historike, informacioni i jashtëm i referencës i publikuar nga agjencitë e njohura të vlerësimit të jashtëm të kreditit të tilla si Moody's përdoren për të plotësuar të dhënat në dispozicion brenda vendit.

Informacionet e ardhshme (forward-looking)

Sipas SNRF 9, Banka përfshinë informacione të ardhshme në të dyja vlerësimet e saj nëse riskut kreditor i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe matja e saj HPK-së. Banka formulon një pamje "të rastit bazë" të drejtimit të ardhshëm të variabla ve përkatëse ekonomike dhe një gamë përfaqësuese të skenarëve të tjerë të mundshëm të parashikimit bazuar në këshillat e Komitetit të Riskut të Bankës dhe ekspertëve ekonomikë dhe shqyrtimin e një sërë informacionesh të jashtme aktuale dhe parashikuese.

Ky proces përfshinë zhvillimin e dy ose më shumë skenarëve ekonomikë shtesë dhe duke marrë parasysh probabilitetet relative të secilit rezultat. Informacioni i jashtëm mund të përfshijë të dhëna ekonomike dhe parashikime të publikuara nga organet qeveritare dhe autoritetet monetare në vendet ku vepron Banka, organizata mbikombëtare si Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe sektori privat i përzgjedhur dhe parashikuesit akademikë.

Rasti bazë paraqet një rezultat më të mundshëm dhe të harmonizohet me informacionin e përdorur nga Banka për qëllime të tjera, siç është planifikimi strategjik dhe buxhetimi. Skenarët e tjerë do të përfaqësojnë rezultate më optimiste dhe më pesimiste. Banka gjithashtu kryen në mënyrë periodike testimin e stresit të goditjeve më ekstreme për të kalibruar përcaktimin e këtyre skenarëve të tjerë përfaqësues.

Banka ka identifikuar dhe dokumentuar nxitësit kryesorë të riskut kreditor dhe humbjet e kreditit për secilin portofol të instrumenteve financiare dhe duke përdorur një analizë të të dhënave historike, ka vlerësuar marrëdhëniet ndërmjet variabla ve makroekonomikë dhe riskut kreditor dhe humbjeve të kredisë. Këta drejtues kryesorë përfshijnë normat e interesit, normat e papunësisë dhe parashikimet e GDP-së. Marrëdhëniet e parashikuara midis treguesve kryesorë dhe vonësve dhe normave të humbjeve në portofole të ndryshme të pasurive financiare janë zhvilluar bazuar në analizimin e të dhënave historike gjatë 5 viteve të fundit.

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme pas 1 janar 2018) (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Paraqitja e lejeve për HPK-në në pasqyrën e pozicionit financiar

Lejimet për humbjet për HPK janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

- pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar: si zbritje nga vlera kontabël bruto e pasurive;
- zotimet e kredisë dhe kontratat e garancioneve financiare: në përgjithësi, si një provizion;
- kur një instrument financiar përfshinë si një komponent të tërhequr dhe një jo të tërhequr, dhe Banka nuk mund të identifikojë HPK-në në komponentin e zotimit të kredisë veçmas nga ato në komponentin e tërhequr të kredisë: Banka paraqet një provizion të humbjes së kombinuar për të dy komponentët. Shuma e kombinuar paraqitet si një zbritje nga vlera kontabël bruto e përbërësit të tërhequr. Çdo tejkalim i provizionit të humbjes mbi shumën bruto të komponentit të tërhequr paraqitet si një provizion; dhe
- instrumentet e matura në VDATGJ asnjë provizion për humbje nuk njihet në pasqyrën e pozicionit financiar sepse vlera kontabël e këtyre pasurive është vlera e drejtë e tyre. Megjithatë, provizioni i humbjes shpalolet në shënimin 15.

Kreditë e shlyera

Kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit shlyhen (pjesërisht ose tërësisht) kur nuk ka një perspektivë reale të rikuperimit. Kjo zakonisht ndodh kur Banka përcakton se huamarrësi nuk ka pasuri ose burime të ardhurash që mund të gjenerojnë rrjedha të parasë të mjaftueshme për të shlyer shumat që i nënshtrohen shlyerjes. Megjithatë, pasuritë financiare që janë shlyer mund të jenë ende subjekt i veprimeve përmbarimore në mënyrë që të jenë në përputhje me procedurat e Bankës për mbulimin e shumave të duhura.

g) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme para 1 janar 2018)

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, investimet e mbajtura deri në maturitet dhe të vlefshme për shitje, depozitat, huamarrjet dhe kreditë e varura në datën që ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e pasurive financiare njihen me datën e tregimit në të cilën Banka angazhohet për të blerë ose shitur pasurinë. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregimit, e cila është data kur Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një pasuri ose detyrim financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo lëshimin e tij, përveç rasteve të pasurive dhe detyrimeve financiare të regjistruara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(ii) Klasifikimi

Pasuritë financiare

Banka klasifikon pasuritë e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- hua dhe llogari të arkëtueshme;
- pasuritë financiare të mbajtura për shitje
 - Kreditë dhe të arkëtueshmet (Politika e aplikueshme para 1 janar 2018)

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim ti shes menjëherë apo në një periudhë afatshkurtër. Kreditë dhe paradhëniet për Banka klasifikohen si kredi dhe të arkëtueshme.

Kreditë dhe paradhëniet njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme para 1 janar 2018) (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Pasuritë financiare (vazhdim)

- Pasuritë financiare të mbajtura për shitje (Politika e aplikueshme para 1 janar 2018)

Letrat me vlerë maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit.

Investimet e mbajtura për shitje janë investime jo-derivative të cilat janë përcaktuar si të vlefshme për shitje ose nuk janë klasifikuar si një kategori tjetër e pasurive financiare. Investimet e mbajtura për shitje përbëhen nga letrat me vlerë të borxhit. Të gjitha investimet e mbajtura për shitje janë matur me vlerën e drejtë, pas njohjes fillestare.

E ardhura nga interesi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor në investimet e mbajtura për shitje njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje (shih (g)(v)).

Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë, përveç humbjeve nga rënia në vlerë (shih (g)(v)), njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse edhe paraqiten në rezervën e vlerës së drejtë brenda ekuitetit. Kur investimi shitet, fitimi ose humbja e akumuluar në kapital ri klasifikohet në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare si të matura me kosto të amortizuar.

(iii) Ç'regjistrimi

Pasuritë financiare

Banka çregjistron një pasuri financiare kur mbarojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhjet e parave nga pasuria financiare ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhjet e parave kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësive së pasurisë financiare janë transferuar ose në të cilat Banka as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësive dhe nuk mban kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohet për ç'regjistrim që është krijuar apo mbajtur nga Banka njihet si një pasuri ose detyrim në vetë.

Në momentin e ç'regjistrimit të një pasurie financiare, diferenca mes vlerës kontabël neto të pasurisë (ose vlera kontabël që i përket pjesës së pasurisë së transferuar), dhe totalit të (i) konsideratës së marrë (përfshirë çdo pasuri të re të përfituar ose detyrim të supozuar) dhe (ii) çdo fitim ose humbje kumulative që është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, njihet në fitim ose humbje.

Detyrimi financiar

Banka ç'regjistron një detyrim financiar kur obligimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose kanë përfunduar.

(iv) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një pasurie ose detyrimi financiar është vlera me të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për rënie në vlerë.

(v) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Rënia në vlerë e kredive dhe paradhënieve

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që pasuritë financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes kanë rënë në vlerë. Një pasuri financiare ose një grup pasurish financiare është rënë në vlerë kur evidenca objektive demonstroi se një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhat e ardhshme të parasë së pasurisë ose grupeve të pasurive dhe që mund të vlerësohet me saktësi.

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme para 1 janar 2018) (vazhdim)

(v) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Rënia në vlerë e kredive dhe paradhënies (vazhdim)

Evidenca objektive që pasuritë financiare kanë rënë në vlerë mund të përfshijnë vështirësi financiare të konsiderueshme të huamarrësit ose emetuesit, mos pagesa nga huamarrësit, ristrukturimin e një kredie apo paradhënie nga Banka me kushte që Banka përndryshe nuk do t'i kishte konsideruar, indikacione që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup pasurish të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesit në grup, apo kushtet ekonomike që tregojnë me dështimin në bankë.

Banka i konsideron evidencat e rënies në vlerë për kreditë dhe paradhëniet si në një pasuri në nivel specifik dhe të përgjithshëm. Të gjitha kreditë dhe paradhëniet individualisht të rëndësishme vlerësohen specifikisht për rënie në vlerë. Ato që nuk janë individualisht të rëna në vlerë vlerësohen kolektivisht për çdo rënie në vlerë që ka ndodhur por nuk është identifikuar ende. Kreditë dhe paradhëniet me karakteristika të ngjashme të riskut.

Për qëllime të vlerësimit kolektiv të rënies në vlerë, pasuritë financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut kreditor (lloji dhe shuma e kredisë). Bazuar në të dhënat historike për secilën nga këto grupe llogaritet një faktor humbjeje. Këta faktorë të pritsëm të humbjes janë përshtatur për gjykimin e menaxhmentit nëse kushtet e tanishme ekonomike dhe të kredisë janë të tilla që humbjet aktuale mund të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të sugjeruara nga trendet historike dhe më pas ato aplikohen për të vlerësuar humbjen nga rënia në vlerë në secilin grup. Normat e vonësës, normat e humbjeve dhe koha e pritshme e rikuperimit të ardhshëm regjistrohen rregullisht në krahasim me rezultatet aktuale për të siguruar që ato mbeten të përshtatshme.

Humbjet nga rënia në vlerë e pasurive të matura me koston e amortizuar llogariten si diferenca midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhës së parave të ardhshme të parashikuara, të diskutuara me normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë.

Nëse kushtet e një pasurie financiare ri-negociohen ose modifikohen ose një pasuri financiare ekzistuese zëvendësohet me një të re për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë bëhet vlerësimi nëse pasuria financiare duhet të ç'regjistrohet. Nëse rrjedhjet e parasë të pasurisë së rinegociuar janë në thelb të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale të rrjedhjeve të parasë nga pasuria financiare fillestare janë vlerësuar të kenë skaduar. Në këtë rast pasuria financiare fillestare ç'regjistrohet dhe pasuritë e reja financiare njihen me vlerën e drejtë.

Humbja nga rënia në vlerë matet si më poshtë:

- Nëse ristrukturimi i pritshëm nuk rezulton në ç'regjistrimin e pasurisë ekzistuese, rrjedhjet e parasë të vlerësuar që rrjedhin nga pasuria financiare e modifikuar përfshihen në matjen e pasurisë ekzistuese bazuar në kohën e pritshme dhe shumat e diskutuara me normën fillestare efektive të interesit të pasurisë financiare ekzistuese.
- Nëse ristrukturimi i pritshëm rezulton në ç'regjistrimin e pasurisë ekzistuese, atëherë vlera e drejtë e pritshme të pasurisë së re trajtohet si rrjedha e parave të gatshme nga pasuria financiare ekzistuese në kohën e ç'regjistrimit të saj. Kjo shumë zbritet nga data e pritshme e ç'regjistrimit deri në datën e raportimit duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë financiare ekzistuese.

Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari të provizionit kundrejt kredive dhe paradhënies. Kur një ngjarje që ndodh pas njohjes së rënies në vlerë shkakton zvogëlimin e humbjes nga rënia në vlerë, zvogëlimi në humbje nga rënia në vlerë kthehet në fitim ose humbje.

Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari të lejimit kundrejt kredive dhe paradhënies. Kreditë shlyhen pasi që masa të arsyeshme të mbledhjes janë marrë në përpunje me politikën e vendosur të Bankës. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton zvogëlimin e shumës së humbjes nga rënia në vlerë, zvogëlimi në humbjen nga rënia në vlerë kthehet në fitim ose humbje.

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g) Pasuritë dhe detyrimet financiare (Politika e aplikueshme para 1 janar 2018) (vazhdim)

(v) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Rënia në vlerë e pasurive financiare të mbajtura për shitje

Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka evidencë objektive që një pasuri financiare ose një grup pasurish financiare ka rënë në vlerë. Në rast të investimeve në kapital të klasifikuara si të vlefshme për shitje, një rënie e ndjeshme ose e shtrirë në vlerën e drejtë të letrave me vlerë nën koston e tij është konsideruar në përcaktimin nëse pasuritë janë rënë në vlerë ose jo. Në qoftë se, në një periudhë në vijim, vlera e drejtë e një instrumenti të borxhit të klasifikuar si i vlefshëm për shitje rritet, dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi është njohur humbja nga rënia në vlerë, atëherë humbja nga rënia në vlerë kthehet përmes fitimit ose humbjes, përndryshe çdo rritje në vlerë të drejtë njihet përmes ATGJ.

h) Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë monedhat dhe kartëmonedhat në arkë, gjendet në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorimin e pasurive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë risk të pa konsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e zotimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

i) Depozitat dhe huazimet, dhe kreditë e varura (Politika e aplikueshme para 1 janar 2018)

Depozitat, huazimet dhe kreditë e varura janë burimet kryesore të Bankës për financim.

Depozitat, huazimet dhe kreditë e varura maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

j) Pasuritë e riposeduara

Kolaterali i mbajtur në bazë të marrëveshjes së kredisë mund të posedohet nga Banka vetëm në rast të falimentimit të huamarrësit dhe kryerjes së procedurave ligjore në përpunje me legjislacionin e Kosovës që i mundëson Bankës të marrë titullin e plotë juridik dhe pronësinë. Vetëm pas përfundimit të këtyre procedurave, Banka mund të shesë ose transferojë kolateralin. Pasuritë e riposeduara fillimisht njihen në shumën e përcaktuar me urdhër të gjykatës dhe më pas maten me vlerën më të ulët të kostos dhe vlerën neto të realizueshme dhe çdo fitim ose humbje nga shitja e këtyre pasurive njihet në fitim ose humbje.

Nga njohja fillestare, Banka klasifikon pasurinë e riposeduar në minimum si klasifikim nën standard dhe rezervon provizionimin sipas klasifikimit. Përveç kësaj, Banka njeh kolateralin e riposeduar si një pasuri vetëm kur ka titull të plotë juridik të kolateralit dhe vlera e drejtë e kolateralit mund të përcaktohet me besueshmëri. Banka nuk mund të shesë, transferojë ose ri-pengojë kolateralin nëse procedurat ligjore për transferimin e pronës së rezultuar në vonësë nuk janë plotësuar. Banka mban posedimin e pronave të fituara përmes zbatimit në formën e një hipoteke, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh. Nëse, brenda pesë vjetësh, pasuria nuk është shitur nga Banka, ajo shënohet me zero vlerë.

k) Prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë matur sipas koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga rënia në vlerë.

Kostot historike përfshijnë shpenzime që janë drejtpërdrejtë të lidhura me blerjen e pasurisë. Softueri i blerë që është thelbësor për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje.

Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato llogariten si artikuj të veçantë (përbërësit madhor) të pronës dhe pajisjeve.

Çdo fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të një zëri të pronës dhe pajisjeve aktive (llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël neto të zërit), njihet në të ardhura të tjera në fitim ose humbje.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)
k) Prona dhe pajisjet (vazhdim)
(ii) Kostot pasuese

Kostot pasuese janë kapitalizuar vetëm kur vërtetohet që benefitet ekonomike të ardhshme të atij shpenzimi do të rrjedhin në bankë. Riparimet e vazhdueshme dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në shpenzime në periudhën që kanë ndodhur.

(iii) Zhvlerësimi

Zërat e pronës dhe pajisjeve zhvlerësohen nga data kur ato janë në dispozicion për përdorim. Zhvlerësimi llogaritet për të shlyer koston e artikujve të pronës dhe pajisjeve minus vlerat e përlogaritura të mbetura të këtyre pasurive përgjatë jetës së parashikuar të përdorimit. Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje.

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo pjesë të një zëri të pronës dhe pajisjeve. Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe krahasuese është si vijon:

	Jetëgjatësia
Ndërtesa	20 vite
Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme	5 vite
Automjete	5 vite
Mobilje dhe pajisje	5 vite

Përmirësimet e objekteve me qira zhvlerësohen duke përdorur metodën lineare gjatë afatit më të shkurtër të qirasë, dhe të jetës së tyre të dobishme. Jeta e dobishme e përmirësimeve në objektet e marruar me qira është 5 vjet.

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia e dobishme dhe vlerat e mbetura janë ri-vlerësuar në datën e raportimit dhe janë rregulluar atëherë kur duhet.

l) Pasuritë e paprekshme

Softuerët e blerë nga Banka janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe minus ndonjë humbje e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi pasuritë e sofverëve kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë specifike për të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje gjatë jetës së dobishme të pasurisë, që nga data që është në dispozicion për përdorim.

Softueri amortizohet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së dobishme prej pesë viteve. Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

m) Rënia në vlerë e pasurive jo financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të Bankës, përveç pasurive për tatime të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë. Nëse ka tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një pasurie e tejkalon shumën e saj të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e një pasurie është më e madhe nga vlera e tij në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostoja për shitje.

Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhat e ardhshme të pasurisë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflektojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasurisë dhe risqet specifike për pasurinë.

Humbjet nga rënia në vlerë janë njohur në fitim apo humbje. Humbja nga rënia në vlerë kthehet deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk është njohur humbja nga rënia në vlerë.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)
n) Provizionet

Një provizion njihet nëse si pasojë e një ngjarje të mëparshme, ku Banka ka një obligim ligjor aktual apo konstruktiv që mund të vlerësohet me saktësi, dhe ka mundësi që një dalje e të mirave materiale do të kërkohej për të shlyer obligimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhën e ardhshme të pasurisë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën e pasurisë në kohë dhe sipas rastit, me risqet specifike të detyrimit. Diskontimi i pashmangshëm njihet si kosto financiare.

o) Përfitimet e punonjësve
(i) Planet e përcaktuara të kontributeve

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme që ofrojnë përfitime në formë të pensioneve për punonjësit me rastin e pensionimit. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pensione.

(ii) Përfitimet afatshkurtëra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punëtorëve maten mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime në momentin e ofrimit të shërbimit. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet sipas një bonusi afatshkurtër në të holla ose sipas planit për ndarjen e fitimit nëse Banka ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv për të paguar këtë vlerë si rezultat i shërbimeve në të kaluarën të ofruara nga punonjësi me ç'rast detyrimi mund të vlerësohet me saktësi.

p) Garancionet financiare dhe zotimet për hua (Politika e aplikueshme pas 1 janar 2018)

Përgjegjësi e Bankës sipas secilit zotim matet me vlerën më të lartë të shumës së njohur fillimisht minus amortizimi kumulativ i njohur në pasqyrën e të ardhurave, dhe provizioni sipas matjes me HPK. Për këtë qëllim, Banka vlerëson HPK-të bazuar në vlerën aktuale të pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin për një humbje kredie që ajo shkakton. Mangësitë janë zbritur nga një përaftrim me normën e interesit të rregulluar nga risku që lidhet me ekspozimin. HPK-të që lidhen me kontratat e garancioneve financiare njihen brenda provizioneve.

q) Garancionet financiare dhe zotimet për hua (Politika e aplikueshme para 1 janar 2018)

Garancionet financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës. Angazhimet për hua janë angazhimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të para-përcaktuara. Angazhime të tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar, nëse dhe kur ato bëhen të pagueshme.

r) Dividendët

Dividendët nga aksionet e zakonshme njihen në ekuitet në periudhën në të cilën ato janë miratuar nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit janë paraqitur si ngjarje pas përfundimit të periudhës së raportimit.

s) Rezervat e ekuitetit

Rezervat e regjistruara në ekuitet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës përbëhen nga:

- Rezerva e vlerës së drejtë, që përfshinë ndryshimet në vlerën e drejtë të pasurive financiare në vlerën e drejtë përmes investimeve në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse;
- Rezervat tjera të kapitalit, që përfshinë dallimin ndërmjet humbjeve të akumuluar sipas SNRF dhe BQK;
- Rezerva e rivlerësimit, që përfshinë kolateralin e ri poseduar të regjistruar në pasuri dhe pajisje nga Banka.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
4. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET
4.1 Standardet dhe interpretimet e lëshuara, por ende jo efektive dhe që nuk janë adoptuar

Standardet dhe interpretimet e nxjerra, por që nuk janë ende efektive, deri në datën e nxjerrjes së pasqyrave financiare të Bankës janë dhënë më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është miratuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një qira, KIS-15 Qiratë Operative - Nxitjet dhe KIS-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të qirasë dhe kërkon që qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm në bilanc, ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Standardi përfshinë dy përjashtime njohjeje për qiramarrësit - dhënien me qira të pasurive "me vlerë të ulët" (p.sh., kompjuterët personale) dhe qiratë afatshkurtra (d.m.th., me qira me një afat kohor me qira prej 12 muajsh ose më pak). Në datën e fillimit të një qiraje, një qiramarrës do të njohë një detyrim për të bërë pagesa të qirasë (d.m.th. detyrimin e qirasë) dhe një pasuri që përfaqëson të drejtën e përdorimit të pasurisë bazë gjatë afatit të qirasë (d.m.th., e drejta e përdorimit të pasurisë). Qiramarrësi do t'u kërkojë të njohin veçmas shpenzimet e interesit në detyrimet e qirasë dhe shpenzimet e zhvlerësimit në të drejtën e përdorimit të pasurisë.

Qiramarrësit gjithashtu do të u kërkojë që të riasin detyrimin e qirasë me rastin e ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë të ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks apo normë të përdorur për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohë shumën e rivlerësimit të detyrimit të qirasë si një rregullim në të drejtën e përdorimit të pasurisë.

Kontabiliteti i qiradhenësive sipas SNRF 16 është në thelb i pandryshuar nga kontabilizimi i sotëm sipas SNK 17. Qiradhenësit do të vazhdojnë të klasifikojnë të gjitha qiratë duke përdorur të njëjtin parim klasifikimi si në SNK 17 dhe të bëjnë dallimin mes dy llojeve të qirasë: qiratë operative dhe financiare.

SNRF 16 gjithashtu kërkon që qiramarrësit dhe qiradhenësit të bëjnë më shumë informacion shpjegues se sa sipas SNK 17.

SNRF 16 është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Aplikimi i më herëshëm lejohet, por jo përpara se një njësi ekonomike të zbatojë SNRF 15. Një qiramarrës mund të zgjedhë të zbatojë standardin duke përdorur një qasje retrospektive të plotë ose një retrospektivë të modifikuar. Dispozitat e tranzicionit të standardit lejojnë lehtësime të caktuara. Një tregues i marrëveshjeve aktuale të qirasë operative jepet në Marrëveshjet e Qirasë Operative në Shënimin 26.

Banka ka vlerësuar se adoptimi i SNRF 16 më 1 janar 2019 do të sjellë ndryshime në matjen e saj aktuale të pasurive të qirasë dhe detyrimeve të qirasë sipas SNK 17. Banka është në proces të vlerësimit të rezultateve primare nga adoptimi i SNRF 16. Rezultatet e këtij vlerësimi nuk ishin në dispozicion në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare.

Për standardet dhe interpretimet e reja të mëposhtme, Banka parashikon që adoptimi i tyre nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës në periudhën e aplikimit fillestar dhe nuk pritet të kenë ndikim mbi pasqyrat financiare të Bankës:

- **KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **SNRF 17 "Kontratat e sigurimeve"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet financiare"** - Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
4. ADAPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET (VAZHDIM)
4.1 Standardet dhe interpretimet e lëshuara, por ende jo efektive dhe që nuk janë adoptuar (vazhdim)

- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Shitja ose Kontributi i Pasurive në mes të një Investitori dhe Shoqërisë së tij ose Sipërmarrjes së Përbashkët dhe ndryshimet e mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar derisa të përfundohet projekti hulumtues mbi metodën e kapitalit)
- **Ndryshimet në SNK 19: Ndryshimet në Plan, Reduktimet ose Zgjidhja** - kontabilizimi kur një ndryshim, reduktim ose zgjidhje ndodh gjatë një periudhe raportuese (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019)
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2019)
- **Korniza konceptuale në standardet e SNRF** - Për përgatitësit që zhvillojnë politika kontabël bazuar në Kornizën Konceptuale, është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020,
- **SNRF 3: Kombinimet Biznesore (Ndryshimet)** - (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020),
Vlera e drejtë e këtyre pasurive është përcaktuar duke iu referuar vlerave të tregut nga ana e vlerësuesit të jashtëm të pavarur. Vlerat janë provizionuar në varësi të vendndodhjes së tyre, mirëmbajtjes, kushteve dhe rrethanave që pasqyrojnë vonesat e mundshme në shitjen e tyre dhe gjatësinë e kohës për mbajtjen e pasurive.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

19. PASURITË E RI-POSEDUARA (VAZHDIM)

Lëvizjet në zhvlerësimin e pasurive janë si në vijim:

	2018	2017
Më 1 janar	1,411	1,362
Ngarkesat për vitin	62	197
Kthimet nga shitjet/heqjet	(900)	(148)
Më 31 dhjetor	573	1,411

Banka ka shitur tri pasuri të riposeduara në vlerë prej 900 mijë Euro të cilat kanë realizuar fitim prej 428 mijë Euro siç shpjegohet në shënimin 9.

20. PASURITË E PAPREKSHME

	Softuerët
Kosto	
Gjendja më 1 janar 2017	1,050
Shtesat gjatë vitit	245
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,295
Shtesat gjatë vitit	281
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,576
Amortizimi i akumuluar	
Gjendja më 1 janar 2017	824
Shpenzimi për vitin	133
Gjendja më 31 dhjetor 2017	957
Shpenzimi për vitin	217
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,174
Vlera kontabël neto	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	338
Gjendja më 31 dhjetor 2018	402

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

21. PRONA DHE PAJISJET

	Ndërtesat	Përmirësime në objektet me qira	Mobiljet dhe pajisjet	Kompjuterët dhe pajisje të ngjashme	Automjetet	Gjithsej
Kosto						
Gjendja më 1 janar 2017	96	827	485	1,280	653	3,341
Shtesat gjatë vitit	587	173	62	186	97	1,105
Shlyerjet gjatë vitit	-	(53)	(30)	(26)	-	(109)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	683	947	517	1,440	750	4,337
Shtesat gjatë vitit	-	255	181	1,142	176	1,754
Shlyerjet gjatë vitit	-	(94)	(37)	(122)	(161)	(414)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	683	1,108	661	2,460	765	5,677
Zhvlerësimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2017	4	535	462	943	417	2,361
Shtesat gjatë vitit	3	119	51	122	56	351
Shlyerjet gjatë vitit	-	(46)	(29)	(25)	-	(100)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	7	608	484	1,040	473	2,612
Shtesat gjatë vitit	25	152	66	280	72	595
Shlyerjet gjatë vitit	-	(93)	(37)	(121)	(109)	(360)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	32	667	513	1,199	436	2,847
Vlera kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2017	676	339	33	400	277	1,725
Gjendja më 31 dhjetor 2018	651	441	148	1,261	329	2,830

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 Banka nuk ka ndonjë pronë të deklaruar si peng. Në kuadër të pronave dhe pajisjeve më 31 dhjetor 2018 ka ndërtesa me vlerë 651 mijë Euro (2017: 676 mijë Euro) i cili është kolateral i riposeduara dhe që menaxhmenti i shfrytëzon për aktivitetet e përditshme të Bankës.

Në vijim janë disa zëra të prona dhe pajisjet të cilat janë zhvlerësuar plotësisht por që janë ende në shfrytëzim më 31 dhjetor 2018:

Kategoria	Kosto	Zhvlerësimi i akumuluar	Vlera Neto
Ndërtesa	9	9	-
Përmirësimet në objekte me qira	386	386	-
Mobilje, orendi dhe pajisje	326	326	-
Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme	834	834	-
Vetura	176	176	-
Softuerë	960	960	-
Gjithsej	2,691	2,691	-

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
22. DEPOZITAT NGA KLIENTËT

	2018	2017
Llogaritë rrjedhëse	98,374	70,685
Në Euro	95,050	67,132
Në valuta të huaja	3,324	3,553
Depozitat e afatizuara	123,219	107,095
Në Euro	122,422	106,368
Në valuta të huaja	797	727
Gjithsej	221,593	177,780

23. KREDITË E VARURA DHE HUAMARRJET

	2018	2017
Kreditë e varura		
Blue Orchard	502	-
<i>Individët:</i>		
Valon Budima	420	420
Armend Skeja	420	420
Gjithsej	1,342	840

Gjatë vitit 2018, Banka ka hyrë në një marrëveshje të re huamarrëse me Blue Orchard për një total prej 500 mijë Euro. Huamarrja ka një normë interesi prej 6.5% në vit, e pagueshme në baza gjashtë mujore, dhe principli paguhet në një kësht të vetëm më 12 dhjetor 2026. Më 31 dhjetor 2018, Banka është në pajtueshmëri me kovenantat financiare të marrëveshjes me Blue Orchard.

Kreditë e varura nga individët ripaguhen më 26 dhjetor 2023. Kreditë e varura nga individët nuk kanë kushte të veçanta të bashkangjitura me marrëveshje.

Kreditë e varura janë dhënë nga palët e mësipërme për ti lejuar Bankës të mbajë nivelet minimale të kapitalit rregullator.

Huamarrjet	2018	2017
Huamarrja nga FEEJ	913	3,128
Huamarrja nga KOSEP - BERZH	870	1,015
Huamarrja nga BERZH	2,502	-
Gjithsej	4,285	4,143

Gjatë vitit 2018, Banka ka hyrë në një marrëveshje huamarrëse me BERZH (Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) për një total prej 5,000 mijë Euro. Qëllimi është të ndihmojë financimin e investimeve në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Huamarrja bartë një normë interesi vjetor prej 2.6%, dhe është e pagueshme brenda pesë viteve. Interesi është i pagueshëm në baza gjashtë mujore. Nga shuma totale e huasë prej 5,000 mijë Euro, shuma prej 2,500 mijë euro mbetet e paarkëtuar më 31 dhjetor 2018.

Gjatë vitit 2016, Banka ka hyrë në një marrëveshje huamarrëse me BERZH (Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) për një total prej 1,000 mijë Euro. Qëllimi është për të mbështetur individët privat dhe portofolion e kredive të NVM-ve në lidhje me programin e efikasitetit të energjisë. Huamarrja bartë një normë interesi vjetor prej 3.6%, dhe është e pagueshme brenda pesë viteve. Interesi është i pagueshëm në baza tremujore.

Gjatë vitit 2015, Banka ka hyrë në një marrëveshje huamarrëse me FEEJ (Fondi Evropian për Evropën Juglindore) për një total prej 4,000 mijë Euro. Qëllimi është për të mbështetur individët privat dhe portofolion e kredive të NVM-ve. Huamarrja bartë një normë interesi vjetor prej 3.4%, dhe është e pagueshme brenda tri viteve. Interesi është i pagueshëm në baza tremujore.

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 Banka është në përputhje me kovenantat financiare të marrëveshjes me FEEJ, KOSEP dhe BERZH.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
23. KREDITË E VARURA DHE HUAMARRJET (VAZHDIM)
23.1 Ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e financimit paraqiten si më poshtë:

	1 janar 2018	Hyrjet e parasë	Daljet e parasë	Interesi akruar	Dividenda e deklaruar	31 dhjetor 2018
Kreditë e varura	800	500	-	42	-	1,342
Huamarrjet	4,143	2,500	(2,343)	(15)	-	4,285
Dividendat e pagueshme	-	-	(428)	-	428	-
Gjithsej detyrimet nga aktivitetet financuese	4,943	3,000	(2,771)	27	428	5,627

	1 janar 2017	Hyrjet e parasë	Daljet e parasë	Interesi akruar	Dividenda e deklaruar	31 dhjetor 2017
Kreditë e varura	1,845	-	(1,005)	-	-	840
Huamarrjet	4,248	1,500	(1,595)	(10)	-	4,143
Dividendat e pagueshme	-	-	(285)	-	285	-
Gjithsej detyrimet nga aktivitetet financuese	6,093	1,500	(2,885)	(10)	285	4,983

24. DETYRIMET TJERA DHE PROVIZIONET

	2018	2017
Të pagueshmet në emër të palëve të treta	788	712
Provizionet për letër garancionet e lëshuara nga Banka	12	19
Të pagueshmet për transaksionet e kliringut me BQK-në	364	630
Të pagueshmet në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave	61	121
Detyrime ndaj furnitorëve	174	191
Gjithsej detyrime tjera	1,399	1,673
Provizione tjera (shiko shënimin më poshtë)	482	506
Gjithsej	1,881	2,179

Vlera kontabel bruto për gjithsej letër garancionet, është dhënë më poshtë:

	2018 – Letër garancionet					2017
Vlerësimi i brendshëm	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej	Gjithsej
A0	1,419	501	-	-	1,920	1,228
A1	25	10	-	-	35	35
B	-	-	-	-	-	26
C	-	12	-	-	12	-
Vonesë	-	-	5	-	5	15
Gjithsej	1,444	523	5	-	1,972	1,304

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
24. DETYRIMET TJERA DHE PROVIZIONET (VAZHDIM)

Një analizë e ndryshimeve në korrespondimin e vlerës kontabël bruto dhe humbjeve të pritshme nga letër garancionet janë si më poshtë:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	
	HPK 12-muaj	HPK të përhershme	HPK të përhershme	Kreditë e rena në vlerë në origjinë	Gjithsej
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2018	323	966	15	-	1,304
Transferet					
Transferet nga Faza 1 në Fazën 2	-	-	-	-	-
Transferet nga Faza 1 në Fazën 3	(7)	-	7	-	-
Transferet nga Faza 2 në Fazën 3	-	-	-	-	-
Transferet nga Faza 3 në Fazën 2	-	5	(5)	-	-
Transferet nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	-	-	-
C' regjistrime tjera përveç kredive të shlyera	(206)	(445)	(15)	-	(666)
Ripagimet dhe ndryshimet në rrjedhat e parasë	-	-	-	-	-
Pasuritë e reja financiare të gjeneruara ose të blera	1,334	-	-	-	1,334
Kreditë e shlyera	-	-	-	-	-
Ndikimi i valutave të huaja dhe lëvizjet tjera	-	-	-	-	-
Vlera kontabël bruto më 31 dhjetor 2018	1,444	523	5	-	1,972
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	
	HPK 12-muaj	HPK të përhershme	HPK të përhershme	Kreditë e rena në vlerë në origjinë	Gjithsej
Vlera e humbjeve të pritshme nga kreditë më 1 janar 2018	1	8	15	-	24
Transferet					
Transferet nga Faza 1 në Fazën 2	(2)	-	2	-	-
Transferet nga Faza 1 në Fazën 3	-	-	-	-	-
Transferet nga Faza 2 në Fazën 3	-	(1)	1	-	-
Transferet nga Faza 3 në Fazën 2	-	-	-	-	-
Transferet nga Faza 3 në Fazën 1	-	-	-	-	-
Ndryshimet në PD/KND/END	-	-	-	-	-
C' regjistrime tjera përveç kredive të shlyera	(1)	(2)	(14)	-	(17)
Pasuritë e reja financiare të gjeneruara ose të blera	5	-	-	-	5
Kreditë e shlyera	-	-	-	-	-
Ndikimi i valutave të huaja dhe lëvizjet tjera	-	-	-	-	-
Ndryshimi neto në Fitim dhe Humbje	2	(3)	(11)	-	(12)
Vlera e humbjeve të pritshme nga kreditë më 31 dhjetor 2018	3	5	4	-	12

Provizionet e tjera përfaqësojnë një rezervë të krijuar për çështje ligjore kundrejt palëve të treta. Bazuar në politikat dhe procedurat e bankës, banka përcakton në secilin tremujor rezervat aktuale përmes rivlerësimit të secilës çështje ligjore individualisht.

Në vijim është paraqitur lëvizja në provizione më 31 dhjetor:

	2018	2017
Në fillim të vitit	506	404
Shtesat gjatë vitit	1	123
Të shfrytëzuara gjatë vitit	(25)	(21)
Në fund të vitit	482	506

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
25. KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT
Kapitali aksionar

Në pajtim me Ligjin nr. 04/L-093 për "Banka, Institucione Microfinanciare dhe Institucione Financiare Jo-Bankare", kapitali aksionar minimal për bankat që operojnë në Kosovë duhet të jetë 7 milion Euro.

Më 31 dhjetor 2018 kapitali aksionar i autorizuar ishte i përbërë nga 28,530 aksione të zakonshme (2017: 28,530 aksione të zakonshme). Aksionet e zakonshme kanë një vlerë nominale prej 394.2 Euro secili. Pronarët e aksioneve të zakonshme kanë të drejtë të marrin dividendë që deklarohen kohë pas kohe dhe kanë të drejtë e një vote për aksion në mbledhjet e Bankës. Të gjitha aksionet renditen në mënyrë të barabartë në lidhje me pasuritë e mbetura të Bankës.

Një përmbledhje e strukturës së pronësisë është si vijon:

Nr.	Emri i aksionarit	2018		2017	
		%	Euro ('000)	%	Euro ('000)
1	Afrim Govori	21.27	2,392	21.27	2,392
2	Rrustem Aliaj	17.27	1,942	17.27	1,942
3	Shaqir Palushi	11.81	1,328	11.81	1,328
4	EBRD	10.00	1,125	10.00	1,125
5	Mejdi Rexhepi	9.35	1,052	9.35	1,052
6	Moneta sh.p.k	7.39	833	7.15	804
7	Nazmi Viça	6.89	775	6.89	775
8	Kareman Limani	4.85	545	4.85	545
9	Banka di Cividale	4.62	520	4.62	520
10	Ahmet Arifi	2.39	269	2.39	269
11	Ismet Sylejmani	1.90	214	1.90	214
12	Besnik Vrella	0.46	52	0.50	57
13	Luani Limited	0.44	49	0.44	49
14	Naser Aliu	0.40	45	0.5	57
15	Agim Bilalli	0.40	45	0.5	57
16	Sokol Krasniqi	0.38	42	0.38	42
17	Naim Abazi	0.09	9	0.09	9
18	Flamur Bryma	0.09	10	0.09	10
Total		100.00	11,247	100.00	11,247

Rezerva tjera të kapitalit

Rezerva tjera të kapitalit janë krijuar që nga 31 dhjetori 2011 si diferencë mes humbjes së akumuluar në përputhje me SNRF dhe BQK të cilat janë fshirë me anë të një reduktimi në kapitalin aksionar. Si rezultat i kësaj, këto rezerva janë të kufizuara dhe nuk mund të shpërndahen.

Rezerva për rivlerësim

Gjatë vitit 2014, Banka ka vendosur të përfshijë në kategorinë e pronës dhe pajisjeve një ndërtesë e cila ka qenë me parë pasuri e riposeduar. Ndërtesa u njoh nga Banka në prona dhe pajisje me shumën korresponduese në rezervën e rivlerësimit në kapital.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
26. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Banka lëshon garancion për klientët e saj. Këto instrumente bartin një risk kreditimi të ngjashëm me ato të kredive të dhëna. Garancionet e lëshuara në favor të klientëve janë siguruar me kolateral në para dhe kolateral jo në para (pasuri të paluajtshme dhe kolateral të luajtshëm).

Garancionet e lëshuara të klientëve	2018	2017
Të siguruar me depozita kesh	1,344	591
Të siguruar me kolateral (patundshëmi dhe kolateral i luajtshëm)	628	713
Minus: Provizionet e njohura si detyrime	(12)	(19)
Gjithsej	1,960	1,285

Zotimet përfaqësojnë balancat e pa tërhequra të kredive, mbitërheqjeve dhe limitet e kredit kartelave të lëshuara të klientët.

Zotimet për kredi	2018	2017
Kreditë e aprovuara por të padisbursuara	249	51
Limitet e pashfrytëzuara të mbitërheqjeve	5,822	5,395
Kredit kartelat e pashfrytëzuara	703	453
Gjithsej	6,774	5,899

Ligjore

Banka përfshihet në procedura të zakonshme ligjore në rrjedhën normale të biznesit më 31 dhjetor 2018 dhe 2017. Menaxhmenti i Bankës është i mendimit se nuk do të lindin humbje materiale në lidhje me kërkesat ligjore, përveç atyre të parashikuara dhe të njohura në fitim ose humbje siç shpalosen në Shënimin 24.

Zotimet e qirasë

Banka ka zotime për qira të cilat janë të detyrueshme e që përbëhen si në vijim:

	2018	2017
Jo më vonë se 1 vit	84	138
Me shume se një vit dhe jo më shumë se 5 vite	589	504
Gjithsej	673	642

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR
27.1 Hyrje dhe përmbledhje

Banka është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i pasurive financiare:

- risku i kreditimit
- risku i tregut
- risku i likuiditetit
- risku operacional

Ky shënim prezanton informata për ekspozimin e bankës ndaj secilit nga risqet e përmendura më lartë, objektivin e Bankës, politikat dhe procedurat për matjen dhe menaxhimin e riskut dhe menaxhimin e kapitalit të bankës.

Korniza për menaxhimin e riskut

Bordi i drejtorëve ("Bordi") ka përgjegjësi për themelimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit për menaxhimin e riskut të Bankës. Bordi ka themeluar Komitetin e Auditimit, Komitetin e Riskut dhe Komitetin e Burimeve Njerëzore, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të bankës mbi menaxhimin e riskut në fushat e tyre specifike. Të gjitha komitetet e Bordit raportojnë rregullisht në Bordin e Drejtorëve për aktivitetet e tyre.

Politikat e Bankës për menaxhimin e riskut janë themeluar për të identifikuar dhe analizuar risqet me të cilat ballafaqohet Banka, për të vendosur kufizimet e duhura të riskut dhe kontrollit si dhe të monitorojnë riskun dhe respektojnë limitet. Politikat dhe sistemet për menaxhimin e riskut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara.

Banka, përmes trajnimeve, procedurave dhe politikave për menaxhim, synon të zhvillojë një ambient kontrollues konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Komiteti i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat për menaxhimin e riskut të Bankës dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e kornizës për menaxhimin e riskut në raport me risqet me të cilat përballë Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës në këto funksione ndihmohet nga Departamenti për Auditimin e Brendshëm. Auditimi i Brendshëm kryen rishikimet e rregullta dhe Ad-hoc të kontrollit dhe procedurave për menaxhim të riskut, rezultati i të cilave raportohet tek Komiteti i Auditimit.

Banka operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike dinamike në zhvillim e sipër. Zgjerimi i saj mund të rezultojë në implikime negative në pozicionin financiar të Bankës. Menaxhmenti i Bankës monitoron çdo ditë pozicionin e pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këtë, menaxhmenti analizon përfutueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe implementon masa të përshtatshme në lidhje me kredi, tregun (kryesisht normën e interesit) dhe riskun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet sfidave të tregut duke mbajtur një kapital dhe pozicion likuiditeti të mjaftueshëm.

27.2 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjeve financiare për Bankën nëse një klient apo një palë tjetër e lidhur për një instrument financiar dështon të përmbushë detyrimet kontraktuale, që vijnë nga kreditë dhe paratëdhënit e Bankës për klientët dhe për bankat e tjera. Me qëllim të raportimit të menaxhimit të riskut, Banka merr parasysh dhe konsolidon të gjitha elementet e ekspozimit ndaj riskut kreditor (të tilla si risku standard i huamarrësve individual, risku shtetëror dhe sektorial).

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)
27.2 Risku kreditor
Menaxhimi i riskut kreditor

Bordi i Drejtoreve e ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e riskut kreditor në lidhje me autoritetin e huadhënies në Departamentin e Riskut për kategoritë e mëposhtme: kreditë e biznesit (Korporatë,NVM dhe Mikro duke përfshirë edhe segmentin Agro) dhe kreditë personale PI deri në 50 mijë Euro, të cilat duhet të aprovohen nga Departamenti i Riskut Kreditor.

Ekspozimet kreditore më të mëdha se 50 mijë Euro dhe më pak se 10% e kapitalit të klazit të parë të Bankës aprovohen nga Departamenti i Riskut Kreditor / Komiteti i Kredive, ndërsa ekspozimet mbi 10% të kapitalit të klazit të parë të Bankës duhet të aprovohen nga Bordi i Drejtoreve sipas Politikës së Riskut Kreditor.

Bazuar në kërkesën e autoritetit rregullator, gjatë vitit 2017, Banka ka bërë ndryshime në përgjegjësitë e menaxhimit të riskut dhe veçanërisht në menaxhimin e riskut kreditor, ku Departamenti i Riskut është ndarë në dy departamente të veçanta, Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe Departamentin e Riskut Kreditor.

Departamenti i Menaxhimit të Riskut është përgjegjës për përpilimin apo rishikimin e politikave dhe procedurave që lidhen me riskun kreditor dhe njëkohësisht është përgjegjës për procesin e vlerësimit të pronave të paluajtshme, procesin e monitorimeve të kredive, klasifikimin e kredive dhe peshimin e mjeteve të riskut sipas Rregullores së Adekuatshmërisë së Kapitalit si dhe identifikimin e riskut kreditor që rrjedhë nga produktet/proceset e reja që involvojnë kreditimin. Departamenti i Menaxhimit të Riskut është i organizuar në tre sektorë duke përfshirë Sektorin e Riskut Kreditor, Sektorin e Riskut të Tregut dhe Likuiditetit, si dhe Sektorin e Riskut Operacional.

Departamenti i Riskut Kreditor është përgjegjës për menaxhimin e procesit të vlerësimit të aftësisë kreditimarrëse dhe kapacitetit kreditor, vlerësimin e mjaftueshmërisë së kolateralit, procesin e vendimarrjes, monitorimin/menaxhimin e kredive problematike dhe jo-performuese, duke i përfshirë edhe kreditë në humbje dhe ato jashtëbilancore që menaxhohen nga kompanitë e jashtme (outsourced), si dhe identifikimin e riskut kreditor që rrjedhë nga produktet/proceset e reja që involvojnë kreditimin. Departamenti i Riskut Kreditor përfshinë sektorin e huadhënies dhe sektorin e menaxhimit të vonesave.

Banka ka ndjekur strategjinë e përcaktuar lidhur me diversifikimin e mëtejme të kredive dhe rritjen e portfolios kreditorë sipas segmenteve të përcaktuara të kredive, më saktësisht në segmentet e kredive individuale – PI, segmentin e kredive MIKRO dhe AGRO dhe segmentin e kredive NVM. Gjatë vitit 2018, Banka ka bërë një rritje të konsiderueshme të portfolios kreditorë edhe sipas volumit dhe sipas numrit, dhe rritja kryesisht ka ardhur nga segmentet e synuara të kredive, respektivisht në segmentet e kredive PI, MIKRO dhe AGRO. Për të mbështetur këtë strategji të rritjes në kredi të vogla, Banka është dashur të rris numrin e stafit posaqërisht në nivel të degës, e që rast ka bërë rekrutimin e shumë analistëve të kredive me përvojë kryesisht nga Bankat më të mëdha që operojnë në vend.

Segmenti i portfolios së kredive bazohet në llojin dhe madhësinë e subjektit (huamarrësit), dhe në përgjithësi grupohet në klientët Individualë dhe Biznes.

Klientët Retail ose Individual Privat (PI) dhe në këtë grup futen të gjitha llojet e klientëve që kanë burim kryesor të hyrat nga pagat, qiratë stabile, pensione, honorare dhe të hyra tjera të verifikueshme.

Klientët e biznesit ndahen në tre segmente kryesore; MICRO, NVM dhe Korporata. Ekziston edhe një nënkategori e klientëve të agrobiznesit të grupuar si klientë AGRO, të cilët shpërndahen sipas procedurave të ndarjes ndërmjet sektorëve kryesorë në MIKRO, AGRO dhe NVM AGRO.

Klientët e biznesit konsiderohen të gjithë klientët të cilët kanë burimin kryesor të të ardhurave nga veprimtaria e biznesit. Ndarja ndërmjet segmenteve të biznesit bazohet në qarkullimin vjetor. Të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor deri në 300 mijë Euro konsiderohen si klientë MIKRO. Të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor prej 301 mijë Euro deri në 2 milion Euro konsiderohen klientë të NVM, ndërsa të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor mbi 2 milion Euro konsiderohen si klientë Korporatë.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)
27.2 Risku kreditor (vazhdim)
Menaxhimi i riskut kreditor (vazhdim)

Lidhur me kërkesat rregullative për raportimin sipas IFRS 9, Banka ka rekrutuar konsulent për të asistuar në krijimin e metodologjisë dhe implementimin e softuerit. Gjatë vitit 2018 banka ka zhvilluar modelin dhe metodologjinë duke përfshirë llogaritjet dhe të gjitha dokumentet relevante. Per momentin, banka po bën llogaritjen e rënieve në vlerë përmes aplikacionit Macro excel i cili së shpejti do të zëvendësohet me një softuer të veçantë që është në rrugën e implementimit.

Në funksion të strategjisë së bankës për rritjen e portfolios dhe biznesit të saj në segmentet Mikro dhe NVM, Banka ka lidhur marrëveshje me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, për sigurimin e pjesëshëm të kredive ndaj klientëve NMVM (Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme) që i disburson BPB. Ky fond apo kjo garanci kreditore jepet për të lehtësuar rritjen e kredidhënies nga Banka për NMVM në Kosovë, duke përmirësuar kushtet dhe duke rritur volumin e kredive për NVM-të.

Nga muaji Gusht 2016 Banka ka lidhur marrëveshjen e parë në vlerë prej 1.5 milion Euro me FKGG, duke vazhduar me një kontratë shtesë në vitin 2017 dhe dy kontrata gjatë vitit 2018. Në total shuma e kontratave me KCGF është 8.5 milion euro.

Gjatë vitit 2017, Banka ka vazhduar relacionet me Institucione Financiare Ndërkombëtare (BERZH, FEEJ dhe Blue Orchard), ku ka marrë edhe një linjë kreditore nga BERZH në shumë prej 5 milion Euro. Gjithashtu gjatë vitit 2018, banka ka marrë edhe një kredit të varur nga Blue Orchard në shumë prej 500 mijë Euro.

Banka ka përmirësuar procesin e kreditimit duke zhvilluar një softuer për menaxhimin e aplikacioneve të kredive. Zhvillimi është ndarë në tri faza me qëllim që të mbulojë tërë jetëgjatësinë e kredive nga aplikimi deri në likuidim. Faza ose moduli i parë është zhvilluar dhe gjatë vitit 2017 është funksionalizuar plotësisht. Ky modul ka mundësuar automatizimin dhe digjitalizimin e procesit të huadhënies, i cili ka rritur shpejtësinë e aprovimit dhe në të njëjtën kohë ka rritur cilësinë, sasinë, disponueshmërinë dhe qasjen në informata për klientët. Ky zhvillim ka mundësuar gjithashtu analiza të avansuara shumë-nivelshe dhe kontroll të plotë të procesit të huadhënies deri në detajin e fundit.

Gjatë vitit 2018, banka ka implementuar fazën e dytë të zhvillimit të aplikacionit që ka për objektiv të mbulojë procesin e Monitorimit. Ky modul mbulon monitorimin e ekspozimeve financiare dhe shërben si një sistem i paralajmërimit të hershëm jo vetëm për të menaxhuar dhe mbajtur klientët e kredituar, por edhe për të parandaluar dhe parashikuar përkeqësimin e kushteve financiare të klientëve.

Në muajt në vijim, do të vazhdoj faza e tretë e zhvillimit që ka për objektiv të mbulojë menaxhimin e vonesave dhe arkëtimit të borxheve. Ky modul do të zhvillohet për të mbështetur procesin e menaxhimit dhe arkëtimit të borxheve duke siguruar menaxhim të strukturuar të të dhënave, korrespondencave, alarmeve dhe njoftimeve.

Duke zhvilluar këto tre module kryesore, të gjitha të dhënat në lidhje me huanë dhe klientët e kredisë do të jenë në dispozicion në një vend, të strukturuar dhe të ndërlidhura. Kjo do të mundësojë një qasje holistike në menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin e riskut kreditor.

Përveç rritjes së portfoliut të kredisë dhe uljes së ekspozimeve të mëdha, Banka ka vazhduar me përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së kredive, në përputhje me trendin e përmirësimit të kredive në nivel të industrisë bankare. Sa i përket treguesit të cilësisë së kredisë - kreditë jo-performuese (NPL), ndonëse në vitin 2017 ajo ishte 2.97%, në vitin 2018 ky tregues u përmirësua në 2.87% dhe ishte afër me mesataren e industrisë bankare prej 2.70%. Ka pasur gjithashtu përmirësime në kategoritë e tjera të kredive, kreditë problematike (C, D, E) dhe kreditë në vonesë (B, C, D, E).

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)
27.2 Risku kreditor (vazhdim)
Menaxhimi i riskut kreditor (vazhdim)

Lidhur me përmirësimin e kualitetit të kredive, Banka ka avancuar proceset rreth menaxhimit të vonesave si dhe ka rritur aktivitetet dhe angazhimet, gjë që ka rezultuar që neto provizionet për këtë vit të jenë pothuajse zero. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2018 Banka ka rishikuar dhe vazhduar kontratat edhe me dy kompanitë e jashtme për menaxhimin e kredive në vonesë, sidomos për kreditë e vjetra në kategoritë Humbje dhe Write off, kryesisht për shumat deri në 10 mijë Euro.

Banka rishikon të gjitha ekspozimet kreditore në baza të rregullta, përdërisa klasifikimi dhe raportimi i kredive bëhet në baza mujore në harmoni me kërkesat e Bankës Qendrore.

Ekspozimet kreditore në shumë mbi 50,000 Euro rishikohen në baza tremujore përdërisa po të njejtat monitorohen në baza gjashtëmujore. Ekspozimet nën 50,000 Euro monitorohen në baza vjetore dhe përfshihen analizimin e gjendjes financiare të klientëve duke përfshirë edhe analizimin e gjendjes së kolateralit, ekspozimeve në Banka tjera dhe faktorë tjerë që mund të ndikojnë në performancën financiare të huamarrësit.

27.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë (Politika e aplikueshme nga 1 janar 2018)

Sipas SNRF 9, BPB do të njohë një rënie në vlerë për humbjet e pritshme të kredisë (HPK) në çdo datë raportimi për kreditë dhe paradhënit për klientët e matur me koston e amortizuar (AC).

Përveç kredive dhe paradhënieve për klientë, BPB do të njohë gjithashtu një rënie në vlerë të matur për humbjet e pritshme të kredisë për instrumentet financiare në vijim, nëse:

1. Instrumentet e borxhit të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
2. Marrëveshjet e kredive të matura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
3. Kontratat e garancioneve financiare në të cilat zbatohet SNRF 9 dhe të cilat nuk trajtohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; dhe
4. Kërkesat e qirasë që janë brenda fushëveprimit të SNK 17, Qiratë dhe të arkëtueshmet tregtare ose pasuritë e kontraktuara brenda fushëveprimit të SNRF 15.

Parimet kryesore

Matjet sipas modelit HPK pasqyrojnë modelin e përgjithshëm të përkeqësimit ose përmirësimit të cilësisë së kredisë së instrumenteve financiare, shprehur në aspektin e rritjes së ndjeshme të riskut kreditor.

Kur instrumenti financiar fillimisht gjenerohet l' provizioni i humbjes matet në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme 12-mujore të kredisë. Kur instrumenti i riskut të vonesës rritet ndjeshëm që nga krijimi i tij, Banka do të masë provizionin në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të përhershme të kredisë.

¹ Përveç nëse krijohen si pasuri financiare të rëna në vlerë të cilat u nënshtrohen kërkesave të ndryshme për qellime të rënies në vlerë.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)
27.2 Risku kreditor (vazhdim)
27.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë (Politika e aplikueshme nga 1 janar 2018) (vazhdim)
Modeli me tri faza

Qasja e përgjithshme e SNRF 9 për rënien në vlerë dhe njohjen e të ardhurave nga interesi mund të përmbledhet në modelin e mëposhtëm me tri faza, ku transferimet nga njëra fazë në tjetrën varen nga ndryshimet në riskut kreditor që nga krijimi deri në mospagimin e kredisë.

Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI
Kreditë e reja në origjinë, pa rënie në vlerë	Kreditë ekzistuese me rritje të ndjeshme të riskut nga gjenerimi	Kreditë e rena në vlerë (në vonesë)	Kreditë e rena në vlerë në blerje
Kreditë ekzistuese pa ndonjë rritje të ndjeshme të riskut			Kreditë e rena në vlerë në origjinë
Njohja e humbjes së pritshme nga kreditë			
Humbjet e pritshme nga kreditë 12-mujore	Humbjet e pritshme nga kreditë të përhershme	Humbjet e pritshme nga kreditë të përhershme	Humbjet e pritshme nga kreditë të përhershme
Të ardhurat nga interesi			
Interesi efektiv në vlerën kontabël bruto	Interesi efektiv në vlerën kontabël bruto	Interesi efektiv në vlerën kontabël neto (kosto e amortizuar minus provizionet kreditore)	Interesi efektiv i përshtatur në vlerën kontabël neto (kosto e amortizuar minus provizionet kreditore)

Faza 1 përfshinë kreditë e reja të krijuara që nuk janë kredi të rena në vlerë dhe kredi ekzistuese për të cilat riskut kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, në datën e raportimit. SNRF 9 kërkon që HPK-të për këto kredi të vlerësohen në baza 12 mujore duke marrë parasysh:

- probabilitetin që ekspozimet do të jenë në vonesë brenda 12 muajve pas datës së raportimit (referuar si '12 -mujori PD'), dhe
- humbja përfundimtare e pësuar gjatë jetës në rast të vonesës (referuar si 'humbje e dhënë për vonesë' ose 'KND').

Faza 2 përfshinë kreditë që kanë pasur një rritje të konsiderueshme në riskut kreditor që nga njohja fillestare, por që nuk kanë dëshmi objektive se janë në vonesë. SNRF 9 kërkon që HPK-të për këto kredi të vlerësohen në bazë të jetës duke konsideruar:

- probabiliteti që ekspozimet do të jenë në vonesë gjatë gjithë jetës së mbetur pas datës së raportimit (referuar si 'PD të përhershme') dhe
- humbja përfundimtare e pësuar gjatë jetës në rast të vonesës.

Faza 3 përfshinë kreditë që kanë dëshmi objektive se janë në vonesë në datën e raportimit (pasuri në vonesë). SNRF 9 kërkon që HPK-ët e përhershme të vlerësohen në bazë të humbjes përfundimtare të pësuar.

POCI përfshinë kreditë e krijuara të rena në vlerë dhe kreditë e rena në vlerë të blera me zbritje të madhe. SNRF 9 kërkon që këto kredi fillimisht të njihen me vlerën e drejtë minus humbjet kumulative të kredisë në njohjen fillestare. HPK ri-matet në çdo datë raportimi dhe ndryshimet njihen në fitim dhe humbje.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)
27.2 Risku kreditor (vazhdim)
27.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë (Politika e aplikueshme nga 1 janar 2018) (vazhdim)
Modeli i Humbjes së Pritshme të Kredisë

Për qëllimet e matjes së HPK, BPB kryen parametrin e nevojshëm të modelit bazuar në të dhënat e vërejtura point-in-time në një nivel të detajuar të intervaleve tremujore, të cilat konsiderohen të përshatshme për rrethanat. Llogaritjet e HPK bazohen në parametrat e mëposhtëm hyrës:

Probabiliteti i Dështimit (PD): Kjo shpreh mundësinë e vlerësimit të dështimit për kushtet ekonomike mbizotëruese në datën e raportimit, të përshatshme për të marrë parasysh vlerësimet e kushteve të ardhshme ekonomike që ka mundësi të ndikojnë në riskun e vonësës, në një horizont të caktuar kohor. Të tilla do të jenë HPK 12 mujore për kreditë e Fazës 1 dhe HPK të përhershme për kreditë e Fazës 2. Për kreditë e Fazës 3 dhe POCI PD është 1, sepse vonesa ka ndodhur. Vlerësimi i PD është adresuar në Udhëzimin për modelimin e PD-së.

Ekspozimi në Dështim (END): Ky është një vlerësim i ekspozimit në një datë të ardhshme të vonësës, duke marrë parasysh ndryshimet e pritshme në ekspozimin pas datës së raportimit, duke përfshirë ripagesat e principalit dhe interesit dhe tërheqjen e pritshme në objektet dhe garancionet e zotuar.

Humbja e dhënë në dështim (KND): Kjo paraqet një vlerësim të humbjes që del nga një vonesë. Ajo bazohet në diferencën midis rrjedhave të parasë të gatshme të kontraktuara dhe atyre që kredidhënësi do të priste për të marrë në bazë të kushteve ekonomike aktuale dhe të ardhshme, duke përfshirë çdo kolateral. Zakonisht shprehet si përqindje e END.

Norma e kurimit: Kjo shpreh gjasat e daljes nga statusi i fazës 3.

Norma e diskontimit: Kjo përdoret duke e diskontuar humbjen e pritshme të kredisë në një vlerë aktuale në datën e raportimit. Aneksi 2 ofron normën e diskontimit të zbatueshme për vlerësimin e HPK.

Tabela e mëposhtme ilustron mënyrën e zbatimit të modelit në fazat e ndryshme:

Fazat	Niveli	PD	KND	END
Faza 1	Përgjithshme	PD 12-mujor (përshtatur për kushtet makro-ekonomike)	Humbjet e përhershme	Ekspozimi në dështim gjatë 12 muajve të ardhshëm
	Specifike	Nuk është e aplikueshme *		
Faza 2	Përgjithshme	PD të përhershme (përshtatur për kushtet makro-ekonomike)	Humbjet e përhershme	Ekspozimi në dështim gjatë jetës së mbetur
	Specifike	Nuk është e aplikueshme *		
Faza 3	Përgjithshme	PD është i barabartë me 1, sepse vonesa ka ndodhur	Humbjet e përhershme në varësi të pikës së ciklit të rikthimit	Ekspozimi në vonesë në datën e raportimit
	Specifike		Rrjedhat e parasë së ardhshme të diskontuara në datën e raportimit	

* Vlerësimi individual i probabilitetit të vonësës dhe humbjeve të përhershme është në vetvete e vështirë kur nuk ka dëshmi objektive të rënies në vlerë. Megjithatë, për ekspozimet e rëndësishme të klasifikuara në Fazën 1 dhe Fazën 2, BPB mund të vërtetojë që LGD vlerësohet në baza të përgjithshme për kthimin e pritshëm nga strategjia e përjashtimit të kolateralit për një kredi në vonesë.

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)
27.2 Risku kreditor (vazhdim)
27.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë (Politika e aplikueshme nga 1 janar 2018) (vazhdim)
Sistemi i brendshëm i vlerësimit të bankës dhe procesi i vlerësimit të probabilitetit të vonësës

Departamenti i Riskut Kreditor të Bankës është i pavarur të zbatojë modelet e tij të vlerësimit të brendshëm. Banka zbaton modele të veçanta për portofolin e saj kyç në të cilin klientët e saj vlerësohen nga A0 në Vonësë duke përdorur notat e brendshme.

Më poshtë jepen klasifikimet e brendshme të klasifikimit të kredive të përdorura nga banka me SNRF 9 dhe SNK 39:

Vlerësimi SNK 39	Vlerësimi SNRF 9	Të papaguara më 31 dhjetor 2018	HPK 31 dhjetor 2018	Mesatarja e PD 12 mujor	Mesatarja e KND
Standarde	A0	147,725	844	0.5%	48.9%
Standarde	A1	6,562	235	6.7%	43.6%
Në vëzhgim	B	1,917	213	35.6%	42.5%
Nën-standard	C	2,082	416	22.8%	43.2%
Vonesë	Vonesë	4,747	3,476	100%	30.2%
Gjithsej		163,033	5,184	0.8%	48.8%

Kreditë e riprogramuara dhe të modifikuara

Banka ndonjëherë bën ndryshime në kushtet origjinale të kredive si një përgjigje ndaj vështirësive financiare të kredimarrësit, në vend se të marrë në posedim ose ta detyrojë mbledhjen e kolateralit.

Banka konsideron një kredi të riprogramuar kur këto modifikime jepen si rezultat i vështirësive financiare të pranishme ose të pritshme të kredimarrësit dhe Banka nuk do të kishte rënë dakord me to nëse kredimarrësi do të ishte financiarisht i shëndetshëm. Treguesit e vështirësive financiare përfshijnë kovenantat e vonësës, ose shqetësime të rëndësishme të ngritura nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut. Riprogrami mund të përfshijë zgjatjen e marrëveshjeve së pagesës dhe marrëveshjen e kushteve të reja të kredisë.

Nga 1 janar 2018, kur kredia është rinegociuar ose modifikuar, por nuk është ç'regjistruar, Banka gjithashtu rivlerëson nëse ka pasur një rritje të ndjeshme të riskut kreditor. Banka gjithashtu shqyrton nëse pasuritë duhet të klasifikohen në Fazën 3. Pasi një pasuri klasifikohet si e ristrukturuar, ajo do të jetë e ristrukturuar për periudhën provuese minimale 24-mujore. Në mënyrë që kredia të riklasifikohet nga kategoria e ristrukturuar, klienti duhet të plotësojë të gjitha kriteret e mëposhtme:

Të gjitha pikat më poshtë duhet të konsiderohen si performuese:

- Periudha provuese prej dy viteve ka kaluar nga data kur kontrata e ristrukturimit është konsideruar performuese.
- Pagesa të rregullta me më shumë se një shumë e parëndësishme e principalit ose interesit janë bërë gjatë së paku gjysmës së periudhës provuese
- Konsumatori nuk ka ndonjë kontratë që është më shumë se 30 ditë në vonesë.

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.2 Risku kreditor (vazhdim)

27.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë (Politika e aplikueshme nga 1 janar 2018) (vazhdim)

Kreditë e riprogramua dhe të modifikuara (vazhdim)

Tabelat në vijim paraqesin një përmbljedhje të pasurive të riprogramuara të Bankës:

	Faza 2			Faza 3			Raporti i riprogramimit
	Vlera bartëse bruto	Modifikime të përhershme për T&Cs	Gjithsej kreditë përformuese të riprogramuara	Modifikimi i përhershëm për T&Cs	Gjithsej kreditë përformuese të riprogramuara	Gjithsej kreditë e riprogramuara	
31 dhjetor 2018							
Detyrimet nga bankat	-	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe pradhëniet për klientë							
Korporata	95,435	909	909	32	32	941	0.99%
Individe	67,598	2	2	8	8	10	0.01%
Gjithsej kreditë dhe pradhëniet për klientë	163,033	911	911	40	40	951	0.58%

31 dhjetor 2018

Detyrimet nga bankat

Kreditë dhe pradhëniet për klientë

Korporata

Individe

Gjithsej kreditë dhe pradhëniet për klientë

Vlera bruto e kredive të riprogramuara			HPK e kredive të riprogramuara		
Faza 2	Faza 3	Gjithsej	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
-	-	-	-	-	-
909	32	941	175	14	189
2	8	10	-	5	5
911	40	951	175	19	194

Banka per Biznes Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.2 Risku kreditor (vazhdim)

27.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë (Politika e aplikueshme nga 1 janar 2018) (vazhdim)

Kreditë e ristrukturuara dhe të modifikuara (vazhdim)

Tabelat në vijim paraqesin një përmbljedhje të pasurive të ristrukturuara të Bankës më 31 dhjetor 2017:

	Portfolio performuese			Portfolio jo performuese			Raporti i riprogramimit
	Vlera bartëse bruto	Modifikime të përhershme për T&Cs	Gjithsej kreditë përformuese të riprogramuara	Modifikimi i përhershëm për T&Cs	Gjithsej kreditë përformuese të riprogramuara	Gjithsej kreditë e riprogramuara	
31 dhjetor 2017							
Detyrimet nga bankat	-	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe pradhëniet për klientë							
Korporata	80,974	945	945	1	1	946	1.17%
Individe	55,571	7	7	-	-	7	0.01%
Gjithsej kreditë dhe pradhëniet për klientë	136,545	952	952	1	1	953	0.70%

31 dhjetor 2017

Detyrimet nga bankat

Kreditë dhe pradhëniet për klientë

Korporata

Individe

Gjithsej kreditë dhe pradhëniet për klientë

Vlera bruto e kredive të riprogramuara					Lejimet e rënies në vlerë të kredive të riprogramuara		
Performuese	Joperformuese por as të rëna në vlerë	Joperformuese dhe të rëna në vlerë	Gjithsej	Provizionet specifike	Provizionet e përgjithshme	Gjithsej	
-	-	-	-	-	-	-	-
-	-	-	-	-	-	-	-
871	73	1	945	75	7	82	
-	7	-	7	-	1	1	
871	80	1	952	75	8	83	

Banka per Biznes Sh.a.
Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
27. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)
27.2 Risku kreditor (vazhdim)
27.2.1 Vlerësimi i rënies në vlerë (Politika e aplikueshme nga 1 janar 2018) (vazhdim)

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	
Pasuritë që duhet të maten me kosto të amortizuar	HPK 12-mujore	HPK të përhershme	HPK të përhershme	Të blera ose të rëna në vlerë në origjinë	Gjithsej
Vlera kontabël bruto sipas llojit të pasurive					
Agro	11,562	2,120	29	-	13,711
Korporatë	32,654	16,552	3,453	-	52,659
Kartelat kreditore	100	3	31	-	134
Konsumuese	16,928	8,435	276	4	25,643
Mikro	20,861	7,358	846	-	29,065
Hipotekare	19,379	9,537	73	-	28,989
Veteranët dhe invalidët	3,417	9,404	11	-	12,832
Gjithsej vlera kontabël bruto	104,901	53,409	4,719	4	163,033
Lejimi i humbjes sipas SNRF 9 sipas llojit të pasurive					
Agro	(58)	(97)	(27)	-	(182)
Korporatë	(147)	(758)	(2,552)	-	(3,457)
Kreditë kartela	(4)	-	(33)	-	(37)
Konsumuese	(34)	(142)	(195)	(1)	(372)
Mikro	(80)	(162)	(579)	-	(821)
Hipotekare	(36)	(190)	(58)	-	(284)
Veteranët dhe invalidët	(1)	(22)	(8)	-	(31)
Gjithsej lejimi i humbjes sipas SNRF 9	(360)	(1,371)	(3,452)	(1)	(5,184)

